

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7310 E hënë 2 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Në parlament foli një vajzë mirditore. Më shumë se fjalët (jam i bindur se janë të paktë ata që mbajnë mend sot se çfarë tha), janë lotët e saj që prekën gjithkënd...
Vijon në faqen 18

Nga BELIND KËLLIÇI

Lotët e Gertës, tallja e Ramës dhe mjerimi i ulur këmbëçryq



Opinion **Ditës**

Në emër të Greqisë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të mbrojtjes kombëtare greke, admiralit Evangelos Apostolakis, nënshkroi dokumentin e pranimit të Serbisë...
Vijon në faqen 19

Nga SHABAN MURATI

Dashuri ushtarako-fetare Greqi-Serbi



Homazhet për shkrimtarin pogradecar, detajet

Vdekja e Lasgushit, replikat e familjes me Dritëroin: S'mund të dilja mbi ligjin

“Ismail Kadare dhe Bashkim Shehu shkuan dhe u ankuar kundër meje”

Nga ILIR BUSHI

Një sherr i pazakontë për Lasgush Poradecin ka ndodhur mes dy shkrimtarëve, Agollit e Kadaresë, e kjo për pensionin e tij. Ramiz Alia dhe sëra e tij nuk e donte, ndërsa Mehmet Shehu votonte pro. Kjo situatë u zhvillua edhe mes shkrimtarëve...
Në faqen 13

TERROR NE VLORE, PLAGOSEN FERDINANDI E I BIRI 8 VJEÇ, PLUMBA DHE MIKUT TE TIJ

ATENTATI NDAJ LLANAJT, HISTORI HAKMARRJESH

Dëshmitarët: Vrasësi ishte një i vetëm. Makina që e priste u dogj në afërsi të Fierit. I ati i Ferdinandit u vra 6 vite më parë, ja si ndodhi



(Në foto) Makina ku udhëtonin tre të plagosurit. Makina që u gjet e djegur në Kafaraj të Fierit, e përdorur nga autorët. Pistoleta e gjetur në vendin e ngjarjes
Në faqet 2-3

FJALIMI NE KUVEND

Rigerta përplas PD e PS, Spiropali: Budallallëku nuk ka brirë
Në faqen 5

'SISTEM INAKTIV'

Luan Rama: Provat për radarët, në shërbim të trafikantëve
Në faqen 9

PAS AKSIDENTIT

Arrestohet një avokat, mashtroi për paratë që do të merrnin
Në faqen 10

SIPERMARRSJA

Blerina Ago: Nuk ka më kohë për të humbur, Shqipëria ka nevojë për turizëm cilësor
Në faqet 8-9

STUDIMI



Pëllumb Xhufi: Elita të vjetra e të reja në luftën për pavarësi
Në faqet 16-17


REPORTAZH/ Shqipëria e brishtë, një zvicerane në këto anë më 1922

Qukësi, shpresë në anë të Shkumbinit

Mes bletarëve dhe vreshtarëve: Si t'i shmangemi varfërisë?

Nga FATOS BAXHAKU

E vetmja që i gëzohet shiut që bie pa reshtur është rrota e gurtë e një mulliri të vjetër me ujë. Disa mushka të lagura deri në palcë presin me durim të zotët që kanë ardhur të bluajnë misër. Zhurma që mbizotëron është vetëm



a jo e shiut të rreptë që përplasat mbi plastmasë apo xhama. Jemi në Qukës. Është e enjte, ditë pazari për krejt fshatrat rreth e rrotull. Këndej është dita më e rëndësishme e javës. Por duket se pazari i sotëm do të shërbejë vetëm sa për të përshëndosur njëri-tjetrin...
Në faqet 14-15

ATENTATI NE VLORE HETIMET

39-vjeçari plagoset në gjoks, policia gjen të djegur në Fier makinën e atentatorit

Atentat me 20 plumba kallashnikovi Ferdinand Llanajt dhe mikut të tij

Shkak hakmarrja, lëndohet dhe djali 8-vjeçar

VLORE

Një atentat mafioz me plagosjen e 3 personave, mes tyre edhe një fëmijë 8-vjeçar, tronditi djegë qytetin e Vlorës. Ngjarja e rëndë ndodhi në rrugën Transballkanike, ku një person ende i paidentifikuar qëllimi me breshëri kallashnikovi në drejtim të një automjeti. Të plagosur mbetën Ferdinand Llanaj, 39 vjeç, i njohur me nofkën "i forti i Selenicës" ose "Robi", djali i tij i mitur B.Llanaj, si dhe një i afërmi i tij, shtetasi Dritan Begaj, 50 vjeç. Të plagosurit fatmirësisht ndodhën në spitalin e Vlorës, jashtë rrezikut për jetën. Nga hetimet paraprake, policia ka dyshime të forta se objektivi i atentatit mund të ketë qenë 39-vjeçari Ferdinand Llanaj. Ky i fundit është djali i Baftjar Llanajt, i vrarë në vitin 2011, për përplasje me familjen Xhaferraj, si dhe vëllai i Aleksandër Llanajt, i dënuar me 35 vite burg si autor i së ashtuquajturës "Masakra e Çoles", e ndodhur në 2015-ën dhe ku viktimat mbetën tre persona. Nisur nga këto fakte, grupi hetimor ka dyshime se krimi ndodhi për motive hakmarrjeje. Me të mbërritur në vendin e ngjarjes, blutë e qytetit bregdetar ngritën pika të shumta kontrolli, si dhe nisën të bënin krehjen e zonës, por pa pasur asnjë rezultat për kapjen e atentatorit dhe të bashkëpunëtorit të tij që e ndihmoi ta largonte nga vendi i ngjarjes. Sipas dëshmitarëve okularë, por edhe nga këqyrja e disa kamerave të sigurisë në zonë, u konstatua se autorët u larguan prej andej me një mjet tip "BMF" me ngjyrë të zezë dhe me targa italiane, e cila u gjet e djegur dy orë pas ngjarjes në Kafaraj të Fierit. Brenda kësaj makine, u gjet edhe arma kallashnikovi e përdorur në atentatin e ndodhur paraditen e djeshme, por sipas burimeve është e vështirë që në të gjenden gjurmë gishtash, për shkak se makina është totalisht e djegur. Për kapjen e autorëve dhe në ndihmë të policisë së Vlorës,




Makina që u gjet e djegur në Kafaraj të Fierit, e përdorur nga autorët

20

VETE NË POLICI

Menjëherë pas ngjarjes së ndodhur, policia shoqëroi mbi 20 persona, mes të cilëve ishin disa dëshmitarë okularë, por edhe persona si të dyshuar ose që mund të kenë dijeni për atentatin e ndodhur. Pas marrjes së tyre në pyetje, ata u lanë sërish të lirë.



Makina ku udhëtonin tre të plagosurit

PLAGOSJE NË VRANISHT

Një person ka mbetur i plagosur me armë zjarri mbrëmjen e djeshme, në fshatin Vranisht të Vlorës. Roland Shkurti, 40 vjeç, u qëllua në këmbë pranë banesës së tij. Ende nuk dihen shkaqet dhe motivet e ngjarjes, ndërsa forca policie kanë nisur hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Vëllai i Ferdinand Llanajt, autor i masakrës së Çoles

Saga e hakmarrjes mes familjeve Llanaj dhe Xhaferraj që prej vitit 1998



në këtë qytet zbarkuan edhe efektive të shumta të RENEAs. Ndërkaq, në polici janë shoqëruar mbi 20 persona, dëshmitarë okularë në ngjarje, por edhe persona si të dyshuar ose që mund të kenë dijeni për atentatin e ndodhur.

NGJARJA

Ferdinand Llanaj, djali i tij i mitur, si dhe Dritan Begaj ishin duke udhëtuar me një mjet tip "Mercedes-Benz" me targa VL 6368 C, dhe sapo kishin dalë

nga banesa e 39-vjeçarit. Në momentin që makina ka dalë në rrugën kryesore (Transballkanike), është qëlluar me breshëri plumbash. Për pasojë, të tre personat që ndodheshin në mjet mbetën të plagosur. Burime pranë policisë bënë dije me dije se Llanaj ishte i ulur në pjesën e pasme të mjetit, në vendin e pasagjerit, ku u drejtua edhe pjesa më e madhe e plumbave. Mësohet se 39-vjeçari ka marrë disa

likti i parë i kësaj familjeje është me familjen Xhaferraj, përplasje e nisur që prej vitit 1998. 19 vite më parë, në Selenicë u ekzekutua Gjysh Xhaferraj dhe i dyshuar për krimin ishte Baftjar Llanaj. Ky i fundit u vra në pritë në qershor të 2011-ës dhe asokohe për ngjarjen u arrestua Sako Xhaferraj, djali i Gjysh Xhaferraj. Saga e hakmarrjes nuk do të mbyllet këtu, pasi në shtator të 2011-ës, nipë i familjes Llanaj tentoi të vriste me armë djalin e dytë të familjes Xhaferraj. Ndërsa në janar të 2012-ës, ekzekutohet Nure Xhaferraj,

plagë në trup, njërin prej të cilave e ka marrë në gjoks. Policia sekuestroi në vendin e ngjarjes 20 gëzhoja kallashnikovi, si dhe një pistoletë, e cila nga hetimet rezultoi të ishte e njerit prej të plagosurve. Nga verifikimet rezultoi se autorët e krimin të rëndë udhëtonin me një makinë tip "BMF" të zezë me targa italiane, e cila u gjet me pas e djegur në Kafaraj të Fierit. Sakaq, burimet e lartpërm-

ri, djali tjetër i Gjysh Xhaferraj, ngjarje që ende nuk ka një autor. Por familja Xhaferraj nuk është e vetmja me të cilën Llanaj kanë konflikte. Ngjarja e 7 prillit 2015, e ndodhur në lagjen "1 Maji" në Vlorë, hap një tjetër pistetë hetimesh për prokurorinë. Aleksandër Llanaj, vëllai i Ferdinandit, është cilësuar fajtor dhe dënuar për masakrën e Çoles. Ai së bashku me Ani Begajn dhe Bertil Aliajn, ekzekutuan në lagjen "1 Maji" të Vlorës, shtetasit Albi Limaj, Haki Rakipi dhe Ardi Velaj.

dura pohan dje për "Gazeta Shqiptare" se që prej vitit 2011 kur iu vra i ati, ai lëvizte me makina të blinduara. Ndërsa që prej dy vitesh, e më konkretisht që pas "Masakrës së Çoles", 39-vjeçari lëvizte i shoqëruar. Burimet shtuan më tej, se pas operacioneve të kryera nga policia për bllokimin e makinave të sekuestruara, 39-vjeçari kishin nisur të lëvizte me mjete të thjeshta.

NGJARJA

Dëshmitarët:

Autori i pamaskuar, streha e kapeles i mbulonte fytyrën

Dëshmitarë në vendin e ngjarjes bënë dije me dije se personi që qëlloi me armë kallashnikovi ishte i pamaskuar dhe se në kokë mbante një kapele, streha e së cilës i zinte gjysmën e fytyrës. Sipas tyre, agresori qëlloi me breshëri në një distancë të afërt me mjetin, ndërsa u largua më pas me shpejtësi, ku metra më tutje e priste një makinë me targa të huaja. "Kishte shumë kalimtarë në momentin që u dëgjua të shtënat. Pamë një person që po qëllonte me automatik drejt makinës ndërsa në krahë mbante cantën e armës. Autori nuk ishte i maskuar, por në kokë mbante një kapele me strehë. Streha i kishte zënë pothuajse gjysmën e fytyrës. E gjithë ngjarja ndodhi në pas sekonda dhe ai menjëherë u largua në këmbë prej aty dhe pak më tutje e priste një makinë", - thanë dje për "GSH", disa dëshmitarë që ndodheshin në vendngjarje.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Liaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415 e-mail: marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotaktorëve, Tiranë - Tel: (04) 2359-104 Tel&Fax: (04) 2359-116 Marketingu: Tel: (04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: http://www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



Pistoleta e gjetur në vendin e ngjarjes

PEQIN - Një 63-vjeçar ka rënë në prangat e policisë, pasi qëllloi me armë zjarri në drejtim të një 56-vjeçari. Ngjarja në fjalë ndodhi në fshatin Lisnajë të Peqinit. Burime zyrtare të policisë bënë dije se i arrestuari është shtetasi Mersin Lika, ndërsa në vendin e ngjarjes uniformat blu gjetën dhe sekuestruan 4 gëzhoja pistolete. "Specialistët për Krimet, në Komisarjatin e Policisë Peqin, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit M.L., 63 vjeç, banues në fshatin Lisnajë Përparim. Arrestimi i tij u bë, pasi në fshatin Lisnajë, pas një konflikti për motive të dobëta ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit R.K., 56 vjeç", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, me tu sinjalizuar për ngjarjen e ndodhur, forca të shumta policie mbërritën në vendin e ngjarjes, ku nisën punën për zbardhjen e plotë të rrethanave. Gjatë këtyrjes së vendit të ng-

Policia: Sherri, për motive të dobëta

Qëllloi me armë zjarri në drejtim të 56-vjeçarit, pranga autorit



jarjes, grupi hetimor ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 4 gëzhoja arme zjarri model 56 kalibër 7.62 mm. Ndërsa, gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj 63-vjeçarit Mersil

Lika, policia i gjeti dhe i sekuestroi në cilësinë e provës materiale një armë zjarri (pistoletë) e tipit "TT", një krehër me 7 fishekë model 54 kalibër 7.62 mm. Materialet i kaluan Prokurorisë së

KONFLIKTI
Në njoftimin zyrtar të policisë u bë me dije se konflikti mes autorit 63-vjeçar dhe objektivit të tij kishte nisur në fshatin Lisnajë, për motive të dobëta. Pas sherrit të nisur mes tyre, Mersin Lika ka qëlluar me armë në drejtim të 56-vjeçarit me iniciale R.K.

Rehthit Gjyqësor Elbasan për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Vrasje me dashje, e mbetur në tentativë" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit".

Në 2011-ën u plagos edhe atentatori, policia i nisi hetimet për hakmarrje

VLORE

Ferdinand Llanaj, njëri prej personave të plagosur paraditen e djeshme në Vlorë, është djali i Baftjar Llanajt, i cili është ekzekutuar në 14 qershor të vitit 2011. Në atë kohë, i ati i 39-vjeçarit u qëllua me breshëri plumbash teksa ishte duke lëvizur me po të njëjtin mjet që u qëllua edhe Ferdinand Llanaj. Baftjar Llanajt i ishte zënë pritë, ndërsa i plagosur mbeti edhe njëri prej autorëve të krimit.

VRASJA E BAFTJAR LLANAJT

Baftjar Llanaj u vra në 2011-ën në Selenicë të Vlorës. Atij i ishte zënë pritë nga autorët ndërsa kthehej prej në qytetin bregdetar. Nga plumbat u plagos edhe njëri prej dy atentatorëve, i cili përfundoi në spital në gjendje të rëndë. Ngjarja e rëndë ndodhi më 14 qershor të 2011-ës, rreth orës 18:00, në rrugën që lidh qytezën e Selenicës me Vlorën, në vendin e quajtur "Bishti i Malit". Në atë kohë, policia e Vlorës raportoi se 60-vjeçarit Llanaj i ishte zënë pritë, duke u qëlluar me pas me breshëri automatiku nga të paktën dy persona. Autorët kanë qenë në buzë të rrugës, duke ditur lëvizjet e Llanajt, i cili shkonte shpesh në Selenicë (vendi i lindjes), ku kishte pronat e tij dhe ull-

Baftjar Llanaj u ekzekutua në të njëjtin mjet që udhëtonte dje i biri
I ati i Ferdinandit u vra në pritë 6 vite më parë



Vendi ku u vra Baftjar Llanaj, babai i Ferdinandit

ishte. Sapo autorët kanë parë se makina tip "Benz" me targa VL 6368 C që drejtohej nga Llanaj është afruar drejt tyre, ata kanë nisur të qëllojnë me automatik në drejtim të mjetit. Por, për

shkak të inercisë, makina ka lëvizur për rreth 10 metra, duke përfunduar më pas në një kanal buzë rrugës. Autorët i janë afruar sërisht, duke vazhduar ta qëllojnë atë me armë zjarri, çka i ka

sjellë vdekjen e menjëhershme 60-vjeçarit. Nga breshëria e pakontrolluar e plumbave që u qëllua nga dy autorët, me qëllim eliminimin e Llanajt, i plagosur rëndë mbeti edhe shtetasi

HAKMARRJA

Viktima Baftjar Llanaj u ekzekutua më 14 qershor të 6 viteve më parë për motive hakmarrjeje. Më 2005-ën ai kishte vrarë pas një sherrit babanë e Xhaferrit, ndërsa vëllai i këtij të fundit kishte mbetur i plagosur duke humbur edhe njërin sy. Nisur nga ky fakt, policia ngriti dyshimet se vrasja e Baftjar Llanajt kishte si motiv të vrasjes hakmarrjen.

Sako Xhaferrit, 45 vjeç, nga Selenica, i cili më pas edhe u arrestua si autor i dyshuar i krimit. Nga kontrolli i policisë ushtruar ndaj Xhaferrit, atij iu gjetën një kokore dhe një palë doreza. Po ashtu,

sipas Policisë së Vlorës, e cila në atë kohë bëri edhe këqyrjen e vendngjarjes, u gjetën dhjetëra gëzhoja të nxjerra nga automatiku me të cilin u vra 60-vjeçari. Fillimisht, policia dyshonte se krimi mund të ishte kryer për shkak të hakmarrjes, pasi vite më parë, Llanaj pas një sherrit vrau babanë e Xhaferrit, ndërsa i plagositi të vëllain. Si pasojë e dhunës, më vonë babai i Xhaferrit ndërroi jetë, ndërsa vëllai i tij humbi njërin sy. Nisur nga ky precedent, policia ngriti dyshime të forta se bëhej fjalë për një hakmarrje ndaj Baftjar Llanajt dhe se atentatori kryesor ka qenë Xhaferrit. Pas vrasjes së 60-vjeçarit, autori i dytë i krimit u largua menjëherë prej andej duke i shpëtuar arrestimit të policisë, ndërsa la të plagosur edhe mikun e tij Sako Xhaferrin.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

- "Apartamenti" dublox, me sip. 449.6 m². Nr. Pas. 3/241+1-25, Volum 18, Faqe 211, ZK 9250, e ndodhur në Rrugë "N. Lenë", hyrja 1, Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 330.897 Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 18.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."1. Cemali", Pall. "Fratari", K.6, Tiranë.
- "Magazine" Nr.2, Kati i dytë, me sip. 703.55 m². Nr. Pas. 4/208-ND-N3, Vol.30, Fq.115, ZK 8514, e ndodhur në Rr Skenderbeu/4, Durrës. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 327.600 Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 09.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."1. Cemali", Pall. "Fratari", K.6, Tiranë.

Per cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

Shoqëria përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së palauajtshme:

Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sip. trualli 350 m², dhe sip. banesë 191.9 m². (kati përdhë 191.9 m², kati i 2-të 269.03 dhe katili 269 m²) ndodhur në L. "11 Janari", ZK 2310, Kuçovë në pronësi Agim Isa Zeqja. Çmimi fillestar në ankandin e parë është 16,000,000 Lekë.

Ankandi zhvillohet në datë 03.10.2017, ditën e Martë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rrugë "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për info. Tel:044503458 ose E-mail shoqeriaepermbarimoreaafa2010@gmail.com

Shoqëria përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin e pasurisë së palauajtshme:

Pasurisë me Nr.14/39 e llojit truall+ndërtësë me sip. 115 m², me sip. ndërtësë 95 m² ndodhur në Lagjen "Kushtrim", ZK. Nr.8503 Berat, në pronësi të Bledar Xhemal Shtembari. Çmimi fillestar në ankandin e tretë 1,480,317 lekë.

Ankandi zhvillohet në datë 11.10.2017, ditën e Mërkurë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rrugë "S. Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info. Tel:044503458 ose E-mail shoqeriaepermbarimoreaafa2010@gmail.com

PERVJETORI VIZITA

10-vjetori i vdekjes, kreu i PD: "Rmo për me tregue" të futet në tekstet shkollore

Basha, thirrje qytetarëve: Sot kërcënohet liria e zgjedhjes

"Në PD, një brez i ri me vlera perëndimore"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, në 10-vjetorin e vdekjes së At Zef Pllumit, me një gjuhë të ashpër iu drejtua dje politikës së shqiptarëve sot u cenohet liria e zgjedhjeve. Por, ai u bëri thirrje qytetarëve në mbarë vendin që të keqen ta mbyllin në muze, duke marrë shkas nga vizita e djeshme në Katedralen e Shën Palit në Tiranë, në aktivitetin e organizuar me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së At Zef Pllumit, i cili përjetoj burgjet e egra të diktaturës. Z.Basha u shpreh se vepra e At Zef Pllumit, "Rrno vetëm për me tregue" duhet të jetë pjesë e teksteve shkollore për të rinjtë, ndërsa tha se mesazhi i saj është aktual. "I rekomandoj kujtdo që nuk e ka parë këtë ekspozitë, ta shohë. Mesazhi i At Zef Pllumit ia vlen shumë, pasi sot na kërcënohet liria, liria e zgjedhjet. Jeta dhe veprat e At Zef Pllumit janë një kushtim për lirinë. Vepra e tij "Rrno vetëm për me tregue" duhet të jetë në tekstet shqiptare si një kushtim për njerëzit e lirë, se ia vlen çdo sakrificë kur liria kërcënohet. Veprat dhe jeta e At Zef Pllumit nuk e kanë vendin në muze, por në jetën e përditshme të shqiptarëve, pasi aty e ka vendin e keqja", theksoi Z.Basha. Ndërsa me anë të një reagimi në "Facebook", kryedemokrati shkruan: "Bashkë me z.Bumçi vizitua një ekspozitë të hapur nga vëllezërit françeskanë me rastin e 10-vjetorit të ndarjes nga kjo botë e At Zef Pllumit. I rekomandoj kujtdo që nuk e ka parë këtë ekspozitë, të vijë e ta shohë, është frymëzuese, prekëse. Mesazhi i At Zef Pllumit është se ia vlen çdo sakrificë për lirinë. Dhe ky mesazh kumbon sot shumë sepse liria na kërcënohet, në veçanti na kërcënohet liria e zgjedhjes. Jeta dhe vepra e At Zef Pllumit janë një kushtim për lirinë. Vepra e tij më e njohur, "Rrno vetëm për me tregue" duhet të jetë në tekstet shkollore për rininë shqiptare, si një dëshmi autentike e ferrit komunist, si ndërgjegjia e një shoqërie që e humbi për 50 vjet rrugën e saj dhe si një kushtim për të gjithë njerëzit e lirë, se ia vlen çdo sakrificë kur liria kërcënohet. Së fundmi, dua të them se At Zef Pllumi, vepra, jeta e tij, virtytet e tij nuk e kanë vendin në muze, por në jetën e përditshme të shqiptarëve. Në muze e ka vendin e keqja, e cila bën vend ditë për ditë në jetën e shqiptarëve. Qoftë ky bekimi i heshtur i At Zef Pllumit që shoqëria dhe qytetarët shqiptarë ta gjejnë forcën, ta kyojnë të keqen në muze e ta zbrisin të mirën në jetën e tyre të përditshme". Po dje, kreu i PD-së, Lulzim



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, në 10-vjetorin e vdekjes së At Zef Pllumit

TAKIMI

"Një brez të rinj me vlera perëndimore po rritet në PD. Ata do të kenë mbështetjen time dhe të të gjithë drejtuesve të PD-së në rrugën e tyre drejt politikës. Jam i bindur se ata do të na bëjnë shpejt krenarë të gjithëve", tha z. Basha.

Kryetarja e LDGSH-së, me gratë e PPE: Vota u ble

Vokshi: Zgjedhësit u kërcënuan, krimi minoi zgjedhjet

Kryetarja e LDGSH, KAlbana Vokshi mori pjesë në Akademinë e Forumit të Grave të Partive Popullore Europiane, që u mbajt në Nisë të Francës, nën kujdesin e presidentes Doris Pack. Deputetja e Partisë Demokratike deklaroi se votimi i shqiptarëve u minua nga fenomeni i shitblerjes së votës, ndikim të kimit të organizuar dhe përdorimit të pushtetit nga qeveritarët. "Zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017 u zhvilluan në një atmosferë dhune e presioni të vazhdueshëm, ndërsa PD ishte në aksion për të siguruar lirinë e votës. Paratë e drogës dhe aktivitetet e tjera kriminale devijuan vullnetin e qytetarëve sh-



qiparë. Devijimi i dhunshëm i votës në Shqipëri mund të ketë pasojë fatale për demokracinë. PS kryeministrit Rama me rekorde korrupsioni, me mbështetjen dhe të lidhur me trafikantët të drogës dhe organizatave kriminale, nëpërmjet varfërimit të popullatës dhe në shkelje të të drejtave të njeriut, bleu re-

zultatit e zgjedhjeve, kërcënoi dhe trembi votuesit. Për herë të parë OSBE-ODHIR në raportin final për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri shpreh qartë shqetësimin e madh për parregullitë e vërejtura që ndikuan direkt në shtrembërimin të rezultatit zgjedhor: vota u ble, votuesit u kërcënuan! ?E gjitha kjo, favorizuar edhe nga kontrolli i pothuajse të gjitha mediave nga ana e pushtetit dhe në përndjekjeve të gazetarëve. Këtë të enjte, kryeministri bllokoi të gjitha televizionet të transmetonin edhe punimet e Parlamentit, një histori e paprecedent në censurim të hapur të së drejtës për informim dhe lirisë së gazetarëve", tha Vokshi.

Basha njoftoi se: "Pata kënaqësinë të përshëndes akademinë e lidershit të organizuar nga Instituti Republikan Amerikan (IRI) me të rinj nga Ballkani, e cila po zhvillohet prej katër ditësh në Durrës. Një brez të rinj me mendje të hapur dhe vlera perëndimore po rritet në Ballkan. Ata do t'i çlirojnë shoqëritë tona nga mentalitetet e qasjet e vjetra, do t'i sjellin integritet dhe vlera demokratike politikës. Një brez i tillë

po rritet edhe në PD. Ata do të kenë mbështetjen time dhe të gjithë drejtuesve të PD-së në rrugën e tyre drejt politikës. Jam i bindur se ata do të na bëjnë shpejt krenarë të gjithëve. Jam i lumtur që IRI do të vazhdojë të mbështesë demokracinë shqiptare dhe Partinë Demokratike në veçanti, duke përcjellë vlerat amerikane të lirisë dhe demokracisë dhe vlerat e djathta të Partisë Republikane amerikane në veçanti".



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në akademinë e lidershit të organizuar nga Instituti Republikan Amerikan (IRI) me të rinj nga Ballkani

DORIS PACK

Presidentja e Forumit të Gruas të PPE, Doris Pack shpreh shqetësim për situatën e rënduar ekonomike, sociale dhe politike në Shqipëri. Znj. Pack i bëri thirrje qeverisë në Tiranë të mos pengojë reformat për drejtësinë dhe zgjedhjet si dhe të bëjë hapa konkretë në luftën ndaj korrupsionit dhe krimin.



Ish-kryeministri Sali Berisha

Akuza e ish-kryeministrit: Policia, asnjë masë

Berisha: Bandat bëjnë ligjin, lëvizin të armatosur

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje se bandat e narko-trafikut po bëjnë ligjin në kryeqytet. Duke iu referuar qytetarit dixhital, Berisha shkruan në 'FB' se disa persona lëvizin me mjete të blinduara dhe të armatosur, ndërsa policia nuk merr masa. "Në narko-shtetin e Norvegës, narko-bandat bëjnë ligjin në mes të kryeqytetit! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital. Zoti Berisha, përshëndetje, desha të denoncoj një fakt që në lagjen time, të ish-Parku ka persona që qarkullojnë me mjete të blinduara dhe policia e Tiranës nuk merr masa. Ata janë të armatosur dhe nuk e kanë problem të na terrorizojnë, e kupton vetë ti se kujt bande i përkasin. Ju lutem na ndihmoni se nuk jetojmë këshut! Anonim të lutem, po të dërgoj edhe fotot e makinave të sapoardhura nga Amerika". Po dje, ish-kryeministri i Shqipërisë paralajmëroi se çfarë do të bëjë javën që vjen kryeministri Edi Rama. Berisha me ironi shtoi se piktori dëshatë do lumturorë biznesin duke emëruar ministër-avokat në qeveri dhe duke krijuar 'call center' për ta. "Pasi dështoi në 4 vite të sjellë qoftë edhe vetëm 1 investitor serioz në Shqipëri dhe largoi me dajak dhe plumba në zarfe dhjetëra prej tyre, piktori dëshatë i është rikthyer lumturimit të bizneseve", tha Berisha. Kurse në një tjetër status, duke iu referuar qytetarit dixhital, ish-kryeministri denoncoi se të sëmuret me kancer janë në mëshirë të fatit, pasi në QSUT mungojnë ilaçet. Sipas qytetarit dixhital, tek Onkologjiku në QSUT mungon një lloj ilaçi i quajtur 'Herceptine', i cili kushton nga 500 -1000 vetëm për një seancë.



LSI, Peleshit: Jep dorëheqjen nga ministria, të emërojnë Rigertën në vendin tënd

Rigerta përplas PS-në e PD-në, Spiropali: Budallallëku s'ka brirë

Paloka: Në 2013 ishte kandidate për deputete

Valentina Madani

Rigerta Loku, vajza nga Mirdita me fjalimin e saj në parlament, ngjalli reagime të shumta nga politika duke përplasur pozitën dhe opozitën për atë çfarë ish-studentja e "La Sapienza" përcolli nga plateja e Kuvendit. Partia Demokratike e konsideroi fjalimin e saj si të përgatitur nga Rilindja, kurse përfaqësues të PS-së e mbështetën atë edhe përballë "zbulimit" që opozita i bëri së shkuarës së Rigertës para se të merrej me biznes në vendlindje.



Rigerta Loku

PËRPLASJA

Partia Demokratike e konsideroi fjalimin e Rigertës si të përgatitur nga "Rilindja", kurse përfaqësues të PS-së e mbështetën atë edhe përballë "zbulimit" që opozita i bëri së shkuarës së Rigertës para se të merrej me biznes në vendlindje.



Kryeministri Edi Rama

Kryeministri publikon artikullin e BBC, komentuesi i kujton Rigertën në Parlament

Kryeministri Rama publikoi dje artikullin e BBC, komentuesi i kujton fjalimin e Rigertës në Parlament. Fjalimi i vajzës nga Mirdita që përloti Parlamentin ditën e djeshme do të mbetet gjatë në kujtesën e njerëzve, sepse ajo tha një realitet të hidhur në fshatin ku ajo jetonte. Këtë fjalim, kryeministrit Edi Rama ia kanë kujtuar edhe komentuesit në "Facebook", në përsëritje që kreu i qeverisë bën çdo ditë. "Mirëmëngjesi dhe me këtë transmetim të BBC kushtuar muzikës së mrekullueshme të sazeve shqiptare, ju uroj një të diel të qetë", shkruan Rama në "FB". Por, një komentues ia kthen: "Zoti kryeministër, mirëmëngjesi edhe juve, doja të thosha që ajo vajza që foli në Parlamentin shqiptar ka studiuar në Itali, saktësisht në "La Sapienza", në një nga universitetet më të mira të Italisë, ku nga ajo shkollë kanë dalë edhe presidentët e Italisë. Si ka mundësi që asaj vajze nuk iu ofrua asnjëherë një vend pune? Këto imazhe që publikoni juve çdo ditë për Shqipërinë janë shumë të bukura, por Shqipëria ka nevojë për shumë gjëra elementare, siç është uji, rruga, drita, punësimi, shkolla, shëndetësia, rregullat ligjore, që duhen zbatuar nga të gjithë. Ajo vajzë duhet të prezantojë Shqipërinë dhe jo ata politikanë, që zihen që si ta ndajnë Shqipërinë. Nëse doni që Shqipëria të hyjë në Europë, duhet të merrni në qeverisje njerëz që kanë studiuar si ajo vajza dhe jo hajdutë. Vetëm kështu do realizohet ëndrra e çdo shqiptari".

Fjalimi prekës i Rigertës në Kuvend

Deputeti i LSI: Pse u mallëngjyen oligarkët?

Deputeti i LSI, Shezai Rrokaj, shkruan në "Facebook" mbi atë që vetë ai e quan "e vërteta e Rigertës dhe farsa e mallëngjimit kolektiv". Përmes ironisë, deputeti i LSI shprehet se Rigerta i mallëngjeu oligarkët parlamentarë qeverisës e sejmënët, pasi sipas tij, shumë prej tyre kanë harruar fshatin dhe rrëfjën e vërtetë si legjendë. Më tej, Rrokaj shton se mallëngjimi me rrëfjën e Rigertës forcon bindjen se te populli, politikanët vajtën për t'u dëgjuar dhe jo për ta dëgjuar, gjë që sipas deputetit e tregon fare qartë edhe programi qeverisës. "Po përse u mallëngjyen, lind pyetja. Ka shumë se një përgjigje. Shumë syresh e kanë harruar fare fshatin dhe rrëfjën e vërtetë. Dikush mendoi edhe jetën e vet dikur, para se të hipte në karrige. Si të thuash, u përmallua nga jeta e fëmijërisë. Shumë të tjerë, qeveritarë e besuan sërish atë përrallën e korrik-gushtit se i vetmi koalicion i tyre ishte ai me qytetarët. Ndënjë hipokrit nuk kuptoi gjë fare, por bëri si të tjerët. Si i thonë, kinse u përmallua, se as i hyn fare në punë rrëfjën e vërtetë. Ai është aty për hallin e vet", shkruan z.Rrokaj.



Nën siglën e FRD, votat që fitoi, Loku kandidoi për deputete në 2013

Rigerta Loku, vajza nga Mirdita që kishte studiuar në "La Sapienza" në Romë për shkencën politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, kërkoi votat e bashkëfshatarëve të saj 4 vite më parë nën siglën e FRD-së. Por, vetë elektorati i Mirditës që kishte shansin që ta kishin si përfaqësuese të tyre në Kuvend, në zgjedhjet e 2013-ën nuk i dha votat e mjaftueshme që ajo të dilte deputete për atë zonë. Loku, e cila kishte studiuar në Itali dhe ishte rikthyer në vendlindje ku ka hapur një fermë më dhi, ka kandiduar për deputete në zgjedhjet vendore të 2013 nën siglën e FRD. Pavarësisht intelektit të saj, kjo parti rezultoi e pafuqishme përballë dy partive të mëdha në vend, PD e PS. Sipas tabelës së rezultatit të zgjedhjeve të 2013, populli i Mirditës i ka dhënë vetëm 280 vota Rigerta Lokut, e cila nuk mund të ishte përfaqësuese e tyre me këndë numër votash.

rilindje rurale. Me një kërkim të përciptë në internet, zbulon se zonja nuk merret vetëm me dhi dhe nuk qenka aq e panjohur nga politika... Në 2013-ën, Rigerta Loku rezultoi në listën e Bamir Topit për deputete në Lezhë, në koalicionin me Edvin Ramën. Të tjerat gjykojini vetë. Ka dhe një emision në një televizion publik, ku i nxjerrin njerëz-

putetëve renditi disa nga problematikat me të cilat përballët fshatit, gjë që bëri shumë deputete, deputetë dhe ambasadorë të përloteshin nga fjalimi i saj. Por Luan Rama, pas fotos së publikuar nga Peleshi, ka komentuar duke shkruar: "Shumë e thjeshtë i dashur Niko, jep dorëheqjen nga ministër dhe emërojeni Rigertën në vendin tënd!".

SITUATA DENONCIMI

Valentina Madani

LSI përmes nënkryetarit Luan Rama denoncoi dje përmes provave të mbledhura, çështjeve të radareve të Forcave Detare, duke akuzuar se ato janë vënë në shërbim të trafikantëve të drogës. Sipas tij, nuk është rastësi që pikërisht prej vitit 2015 e deri më sot, periudhë kur Luan Rama shprehet se Shqipëria u mbush me drogë, janë lënë jashtë shërbimit edhe radarët e Sistemit të Integruar të Hapësirës Detare. Ai bëri të ditur se ka me dhjetëra relacione e akte kontrolli, ku provohet se shqetësimi për mosfunksionimin e radarëve është prezent. Duke analizuar dokumentet, Luan Rama është i bindur se mosveprimi i strukturave përgjegjëse në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në mënyrë të veçantë në Komandën e Forcave Detare, e ka vënë Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare në Shqipëri në shërbim të trafikantëve të drogës! "Kompania private kontrollon me kamera aktivitetin e personelit ushtarak! Nuk është rastësi që pikërisht prej vitit 2015 e deri sot, që në fakt është edhe periudha kur e gjithë Shqipëria u mbush me drogë prej kultivimit të stimuluar e të kontrolluar nga trafikantët e Rilindjes, janë lënë jashtë shërbimit edhe radarët e Sistemit të Integruar të Hapësirës Detare! Trafikantët e tonelatave të drogës që vërshuan drejt Italisë duhej ta kishin rrugën të lirë! Duke parë e analizuar të gjitha faktet e dokumentet që disponoj, por edhe nga bisedat me shumë ushtarakë e specialistë të fushës, një gjë mund ta them me bindje: mosveprimi i strukturave përgjegjëse në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në Komandën e Forcave Detare e ka vënë Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare të Republikës së Shqipërisë në shërbim të trafikantëve të drogës! Ka me dhjetëra relacione e akte kontrolli, ku provohet se shqetësimi për mosfunksionimin e radarëve është bërë prezent, mirëpo në vend që të ndërhyhej menjëherë për vënien e radarëve në punë, janë larguar nga postet e punës ushtarakë e specialistë, që kanë ngritur shqetësimin për mosfunksionimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare!", shprehet z.Rama. Ai vë në dukje se në këtë mënyrë jo vetëm që janë krijuar kushte të favorshme për trafikimin e drogës kryesisht drejt Italisë, por janë cenuar rëndë standardet e

LSI: Si anëtare e NATO, Shqipëria ka cenuar standardet e sigurisë së Aleancës

Rama zbardh provat: Radarët e FD, në shërbim të trafikantëve

"Sistemi prej dy vjetësh nuk është operacional"



Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama

Sigurisë Kombëtare! Më tej, z.Rama shton se në këtë mënyrë, Shqipëria ka cenuar standardet e NATO-s, duke e konsideruar rastin skandaloz dhe të paprecedentë. "Dhe si vend anëtar i

NATO-s, Shqipëria ka cenuar në këtë mënyrë edhe vetë standardet e sigurisë së Aleancës! Edhe një fakt tjetër skandaloz dhe i paprecedent! Nga data 20 deri më 22 janar 2016 është ushtruar

kontroll për të evidentuar gjendjen e shërbimeve dhe riparimeve në SIVHD të kryera nga shoqëria e kontraktuar për këtë qëllim, nga i cili rezultoi se nga shoqëria (nuk po e shënojmë emrin e shoqërisë. Shënimi im.) nga data 1 deri më 22 janar 2016 nuk ishin kryer kontrole dhe as shërbime sipas kontratës në SITE-et e PRT-11 Ksamili, PRT-VQ Sarandë, PRT-13 Portopalamo, QO

rin e shoqërisë. Shënimi im.) nga data 1 deri më 22 janar 2016 nuk ishin kryer kontrole dhe as shërbime sipas kontratës në SITE-et e PRT-11 Ksamili, PRT-VQ Sarandë, PRT-13 Portopalamo, QO

Pashaliman dhe PRT-19 Gur, Lushnje. Për defektet e mangësitë e konstatuara do të kem rast të shkruaj një ditë tjetër. Por, sot po veçoj një konstatim të komisionit, që në vlerësimin tim përbën një skandal më vete. Po citoj nga aktkontrolli:

... specialistët e shoqërisë kanë instaluar në çdo SITE të SIVHD-së kamera vëzhgimi për ruajtjen e shërbimeve dhe pajisjeve të SIVHD-së, gjë e cila nuk është parashikuar në kontratën e shërbimit. Kërkojmë nga firma që serveri i këtyre kamerave të instalohet në QVD Plepa, Durrës dhe të monitorohet nga QO, Durrës. (Që do të thotë se firma kontrollon aktivitetin e personelit ushtarak nëpër PRT).

I gjithë shteti e shumë e shumë funksionarë mediokër të qeverisë u mallëngjien e u përlotën nga shfaqja melodramatike në të ashtuquajturin "Parlament Rural" (një emërtesh fyese e poshtëruese!), por askush nuk reagon përballë skandaleve të tilla si mosfunksionimi i radarëve, lënë enkas jashtë funksionin operacional për të lehtësuar punën e trafikantëve të drogës, duke cenuar rëndë sigurinë kombëtare", shprehet z.Luan Rama.

SKANDALI

Nga dokumentacioni dhe relacionet, sipas Luan Ramës, rezultojnë edhe se një kompani private kontrollon me kamera aktivitetin e personelit ushtarak, gjë të cilën ai e cilëson si një skandal.

AKUZA

Nënkryetari i LSI, Luan Rama theksoi se, "që nga viti 2015 janë lënë jashtë shërbimit edhe radarët e Sistemit të Integruar të Hapësirës Detare".

PD-LSI, skeptike për kërkesën e mazhorancës

Tabaku dhe Gjoshja: Integrimi, jashtë programit të PS-së

Dy forcat politike kryesore opozitare, PD dhe LSI, e shohin me skepticism kërkesën e mazhorancës për një tryezë me pjesëmarrjen e kryetarëve të partive për procesin e integritetit. Ish-ministria Klajda Gjoshja tha për "Ora News" se LSI është e gatshme për çdo tryezë që i shërben integritetit, por kjo qeveri e ka të vështirë të flasë, pasi këtë çështje nuk e përfshiu në programin e saj. "Çfarëdo loj tryeze që të kërkohet për integrimin, patjetër që LSI është e gatshme për tu ulur dhe diskutuar, por besoj se integrimi në këtë qeveri është vështirë të diskutohet në tryeza, përse kohë programi i qeverisë e kishte faqen bosh kur diskutohet për integrimin. Kështu që e kam pak të vështirë që nisim të tilla mund të kenë ndonjë rezultat", deklaroi zj.Gjoshja. Ndërsa, deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, shprehet se kërkesa e socialistëve është propagandë, pasi tashmë



ekzistojnë, siç argumenton ajo, instrumentet për të diskutuar mbi integrimin. "Çështja është tek vullneti i mirë që këto instrumente t'i përdorim në të mirë të integritetit dhe jo në kuadër të demagogjisë dhe propagandës. Është e nevojshme që palët të shprehin vullnetin e tyre të mirë, duke marrë masa konkrete dhe duke ndërmarrë reforma konkrete", theksoi zj.Tabaku. Klajda Gjoshja shprehet se përpara se të inicojnë nisim të reja për integrimin, kjo mazhorancë duhet të mos pengojë reformat bazë, që janë nisur për këtë

proces. "Reforma në drejtësi dhe vetingu që janë kushtet kryesore për çeljen e negociatave. Nuk është çështja të krijohet nisim të reja apo ta bëjmë integrimin çështje kombëtare, e cila është tashmë prioritarë", u shpreh Gjoshja. Ndërsa Jorida Tabaku thekson se mazhoranca propagandon, pasi po bëhen hapa pas në plotësimin e prioritetëve. "Sot po ndodh që e gjithë administrata publike, pavarësisht faktit kanë apo jo status të nëpunësit civil dëgjohet që do tu nënshtrohen punësimeve partiake. Qeveria është duke u renditur ndër qeveritë që bën pjesë në atë grup vendesh, ku krimi ulet këmbëkryq me qeverinë, ku droga dhe kanabisi kanë kaluar përmasat e një fenomeni lokal. Së fundi, reforma në drejtësi ka ndodhur që qeveria shqiptare ka ndryshuar strukturën e organeve të vetingu dhe tri organet e vetingu i ka zhveshur nga buxheti", tha Tabaku.



Petrit Vasili

LSI paralajmëron humnerë ekonomike

Vasili: Situata pa kthim, shkollëpaku argaliset

Nënkryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, bën një paralajmërim të errët për situatën ekonomike, ndonëse i pari i qeverisë, Edi Rama ka folur për një rritje ekonomike më shumë se 4%. Sipas Vasilit, paratë po ikin nga vendi, duke e çuar ekonominë drejt një humnerë pa kthim. E ndërsa ironizoi me kryeministrin Rama, Vasili foli sërish për nevojën e një pakti kombëtar për ekonominë. "Paratë po ikin, ekonomia po rrënohet dhe shkollëpaku argaliset me 'call center'". Banka e Shqipërisë raporton se bankat shqiptare po kreditojnë masivisht jo bizneset në Shqipëri, por bizneset në Kosovë, Maqedoni, Turqi dhe jo pak, por plot 505 milionë euro. Këta tregues po rriten vit pas viti. Biznesi shqiptar po përjeton ditë shumë të vështira. Dërdëllitjet televizive të kryeministrit të paditur në kotecin e tij televiziv për 'call center' për biznesin janë lajthitjet e një mendjeje boshe dhe të paaftë, që po e çon vendin drejt një humnerë ekonomike, që prodhon vetëm varfëri të thellë, polarizim të frikshëm shoqëror, deprimim dhe rënien pa kthim. Dikush duhet t'ia shpjegojë këtij kryeministri të paditur, që qesh pa vetëdije, se paratë e drogës dhe krimi që janë ulur këmbëkryq ngado po e shkretotojnë ekonominë e Shqipërisë dhe po i bëjnë edhe investitorët vendës, e jo më ata të huaj, që të ikin nga shtëpitë këmbët", shprehet z.Vasili.

Aksioni kundër informalitetit, ministri mesazh për administratën fiskale

Sot nis faza e dytë e akcionit të qeverisë kundër informalitetit. Një ditë para fillimit të aksionit kundër informalitetit, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ndau mesazhin e tij për administratën fiskale dhe inspektorët në terren. "Aksioni anti-informalitet nuk është një aksion për të mbledhur para për buxhetin e shtetit, sepse mbledhja e taksave dhe të ardhurave ka në thellim parimin e vetëdeklarimit dhe vullnetarizimit. Aksioni anti-informalitet ka në fokus kryesisht korrinë e komunikimit dhe të edukimit të tatimpaguesit dhe sigurisht, të sondimit të zbatueshmërisë së ligjit në sektorë të ndryshëm, të cilët dalin në platformën tonë të menaxhimit të riskut, me risk më të lartë se sa dilnin më parë për shumë arsye, të cilat janë të kategorizuara dhe të standardizuara brenda asaj që ne e quajmë platforma e menaxhimit të riskut", theksoi z.Ahmetaj. Mes të tjerash, ai shtoi se: "Është detyrë e administratës fiskale, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Inspektoratit të Punës që të reflektojnë në terren një zbatueshmëri shumë këmbëulëse të ligjit dhe një modesti maksimum në përfaqësim të qytetarëve dhe sipërmarrjes. Ju garantoj

Arben Ahmetaj: Barazi në treg, ndëshkim nëpunësve abuzues

Porosia: S'do tolerohet asnjë sjellje e padenjë



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

sipërmarrjes, për të reflektuar filozofinë e një qeverie të tërë, e kryeministrit që administrata të jetë në shërbim të qytetarëve dhe në shërbim të sipërmarrjes. Ju garantoj

që nuk do të tolerohet asnjë sjellje e padenjë, e jashtëligjshme, arrogante, e administratës tatimore, doganore apo inspektoratit kundrejt tatimpaguesve. Kjo është

të taksative", deklaroi ministri. Ahmetaj thirri dje në një takim zyrtarë të lartë të Administratës Tatimore, Doganore dhe Inspektoratit të Punës së bashku me grupet e zbatimit në terren, për të ndarë udhëzimet mbi planin e veprimit dhe mbarëvajtjen e aksionit.

TAKIMI

Ahmetaj thirri dje në një takim zyrtarë të lartë të Administratës Tatimore, Doganore dhe Inspektoratit të Punës së bashku me grupet e zbatimit në terren, për të ndarë udhëzimet mbi planin e veprimit dhe mbarëvajtjen e aksionit.

Doganave dhe Inspektoratit të Punës, duke pasur kryesisht në fokus biznesin e madh, por pa lënë jashtë vëmendjes edhe biznesin e vogël, duke realizuar kontroll të plotë në gjithë zinxhirin e transaksioneve deri tek konsumatori final. Përmes platformës së menaxhimit të riskut në DPT, janë identifikuar sektorët me risk dhe bizneset që shfaqin shmangie të përgjegjësive tatimore e doganore, të cilët do të jenë edhe subjektet kontrolli. Por, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka njoftuar se paralelisht me aksionin kundër informalitetit, do të zhvillohet edhe një tjetër reformë e rëndësishme në favor të lehtësimit të shërbimeve publike dhe uljes së burokracisë për sipërmarrjen dhe qytetarët.



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti shitës:** Albpetrol sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03/10/2017
- Lloji i Procedurës standarde të ankandit:** Procedure e hapur
- Objekti i Shitjes:** Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³
- Afati i evadimit:** 600 000 Nm³ brenda 1 viti nga data e nënshkrimit të kontratës dhe 3 000 000 Nm³ brenda 5 viteve nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje gaz shoqerues, sasia 3 000 000 Nm³, gaz i prodhuar në vendburimin Cakran Mollaj.
- Vlera fillestare:**
Cmimi= 0,8 x TTF + K
 - TTF është cmimi në euro/mwh i gazit shoqerues të publikuar në bursën hollandeze.
 - K- është vlera euro/mwh e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të perlogarit nga formula (Ke⁰).
 - Per konvertimin e cmimit nga euro/mwh në euro/Nm³ per gazin e vendburimit Cakran Mollaj do të perdoret koeficienti 0.00781.
- Vendndodhja e gazit shoqerues:** Albpetrol sha Patos
Vendburimi Cakran Mollaj
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Energjise dhe Industrise, Sheshi Skenderbej, Tirane, salla e mbledhjeve kati I-re.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: ne zyren e protokollit të Ministrise se Energjise dhe Industrise, datë 03/10/2017, ora 11:00**
- Informacion mbi dokumentet e ankandit:**
Dokumentet e ankandit mund të terhiqen prane autoritetit shitës me paraqitjen e nje kerkese me shkrim ose ne faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe ne faqen e Ministrise se Energjise dhe Industrise www.energija.gov.al.
Dokumente me pagesë:
Po Jo
- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara dates dhe ores se zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.**

TURIZMI INTERVISTA

Prej tri javësh u zhvilluan takime dhe trajnime, të fokusuar në turizmin dhe idetë inovative me impakt social

Blerina Ago: Nuk ka më kohë për të humbur, Shqipëria ka nevojë për turizëm cilësor

Ago tregon eksperiencën amerikane, risitë dhe ç'do të bëjë në vijim

Blerina Ago është një prej 100 sipërmarrësve të rinj të cilët u përzgjedhën nga Departamenti i Shtetit Amerikan dhe Fondi Gjerman Marshall duke u bërë pjesë e "Young Transatlantic Innovation Leaders Initiative". Për thajse tri javë ajo zhvilloi një sërë takimesh, por dhe trajnimesh, të fokusuar kryesisht në turizmin dhe idetë inovative me impakt social. E sapokthyer andej, Ago tregon eksperiencën amerikane, risitë që mori dhe ç'do të bëjë konkretisht në vijim. E njohur si Blerina e Rafting, ajo nuk kishte si të mos provonte dhe kampionet në Kolorado, ndër më të famshmet, dhe krahasimi i tyre me kampionet e Osumit. Ajo thotë se vendit tonë i nevojitet një turizëm cilësor, ndërsa thekson se nuk ka më kohë për të humbur.

Blerina, sapo je kthyer nga Amerika, si të duket, çfarë ndjesie ke?

Jam kthyer me shumë mall dhe ide të reja, që mezi po pres t'i shoh të realizuara. Kjo eksperiencë më ndihmoi të rivlerësoj potencialin e madh që ka Shqipëria dhe mundësitë e pafundme që në kemi përditë për të përmirësuar jetën tonë dhe për ta bërë Shqipërinë një vend më të mirë për të rinjtë, si gjenerata e ndryshimeve nëpërmjet sipërmarrjes dhe ideve inovative me impakt social.

Disa muaj më parë ti u përzgjedhe mes 100 sipërmarrësve të rinj evropianë nga Departamenti Amerikan i Shteteve të Bashkuara dhe Fondi Gjerman Marshall duke u bërë pjesë e "Young Transatlantic Innovation Leaders Initiative", si aplikove?

Ndodhi shumë rastësisht. Informacionin e gjeta të publikuar në median sociale të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe sapo e lexova m'u duk programi i duhur, ardhur në kohën e duhur, i cili jo vetëm do forconte aftësitë e mia për mendimin strategjik, por gjithashtu do më ndihmonte në zbatimin më të shpejtë të të



gjitha iniciativave ndërmarë në këto vite lidhur me turizmin, zhvillimin rural, edukimin dhe mirëpunësimin e të rinjve.

E prisje të ishe një nga këta 100 të rinj?

Në fakt ishte një aplikim shumë konkurrues, i cili kishte tërhequr interesimin e mbi 650 të rinjve sipërmarrës nga e gjithë Europa që kishin një ide inovative biznesi me ndikim social në vendin e tyre. Jam krenare dhe e lumtur që përfaqësoj Shqipërinë me "Albanian Adventure Resort", një projekt kaq domethënës për Ballkanin dhe i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, rritjen e ekonomisë rurale, edukimin dhe angazhimin në mirëpunësim të grave dhe veçanërisht të të rinjve.

Më shumë se tri javë në Amerikë, na trego pak për aktivitetet aty, trajnimet?

Ishte një eksperiencë fantastike. Gjatë këtyre 3 javëve unë pata mundësinë të eksploroja më shumë rreth ekosistemit të startup-eve dhe

zhvillimit të sipërmarrjes në përmirësimin e jetës së komunitetit. Gjatë javës së parë në Uashington pata mundësinë të vizitoja Departamentin Amerikan të Shtetit dhe Fondin Gjerman Marshall. U njoha me sipërmarrës nga Europa dhe Amerika, duke u bërë pjesë e një rrjeti transatlantik që forcon bashkëpunimin mbi sfidat rajonale dhe globale në frymën e Planit Marshall. Pata privilegjin të takohesha me zyrtarë amerikanë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Marrëdhëniet transatlantike Shqipëri-SHBA dhe bashkëpunimi ndërkufitar midis vendeve evropiane për inovacion janë thelbësore për të ndërtuar ekosisteme sipërmarrjeje të nivelit botëror. Qëllimi im nëpërmjet këtij programi 1-vjeçar është mësimi i praktikave më të mira në lidhje me këtë, të ndërtoj marrëdhënie profesionale ndërkombëtarisht dhe të punoj në Shqipëri për zhvillimin e ekosistemeve lokale përmes iniciativave të shumta, duke përfshirë kon-

tributin në hartimin e politikave në mbështetje të tyre. Në Kolorado qëndrova në Denver dhe gjithashtu vizitova Boulder dhe Buena Vista me qëllimin për të eksploruar në terren qendra të turizmit aventurë, për të takuar operatorë ndërkombëtarë në kërkim të destinacioneve të reja për klientët e tyre dhe për të mësuar mbi një model të ri universitar i përshtatur për inovatorët, udhëheqësit dhe sipërmarrësit socialë të gjeneratës së ardhshme. Sigurisht që të gjithë morën një ftesë të hapur për të vizituar Shqipërinë në çdo kohë.


Çfarë mësove nga Amerika?

Me impresionoi se si mbrohej guximi i gjeneratës së ardhshme, në mënyrë që arsimimi dhe edukimi i tyre të ndiqte jetën inovatore dhe të kontribuohte në zgjidhjen e sfidave më të vështira me të cilat ballafaqohet bota sot.

Është interesante se Kolorado ka një ekosistem të ri startup-i dhe tani po diversifikon ekonominë e saj nga nafta dhe gazi për t'u fokusuar më shumë në segmente të tjera relevante përmes promovimit të sipërmarrjes. Bujqësia, prodhimi, minierat dhe turizmi janë sektorët më të mëdhenj të

zhvillimit ekonomik atje. Denver mikpritri 31.5 milionë vizitorë në 2016, ku 17.3 shpenzuan të paktën një natë atje, duke vendosur edhe një rekord të ri turistik, sipas një studimi nga "Longwoods International", një firmë kërkimore turistike. Që kur votuesit e Denverit miratuan një rritje të taksave në vitin 2005 për të financuar rritjen e marketingut të turizmit, turizmi është trefishuar krahasuar me ritmin e mesatares kombëtare, me një rritje prej 62 për qind, krahasuar me 22 për qind në nivel kombëtar. Totali i shpenzimeve sipas sektorit për 2016 është për akomodimin \$ 1.57 milion; për transportin \$ 1.05 milion; për ushqimi dhe pije \$ 1.52 milion dollarë; shitja me pakicë e të mirave \$ 660; argëtimi dhe aktivitetet e rekreacionit \$ 476 milionë dollarë.

Ekziston një potencial i madh për shkëmbimin transatlantik midis Shqipërisë dhe Kolorados në këtë drejtim. Duke ecur përpara, do të punojmë në lehtësimin e platformave për të ftuar sipërmarrës, investitorë dhe njerëz të tjerë ndërkombëtarë në ekosistemet start-up për të krijuar vetëdije rreth Shqipërisë. Jam shumë e entuziazmuar



për hapat e ardhshëm. Faleminderit Departamentin Amerikan të Shtetit dhe Fondit Gjerman Marshall dhe gjithë personave që më pritën, pasi e bënë qëndrimin tim absolutisht të mahnitshëm!

Besoj që ke bërë edhe rafting në Kolorado; si ishte si eksperiencë?

Sigurisht që s'mund të largohesha nga Kolorado pa provuar rafting. Zgjedha të lundroja në Browns Canyon në Buena Vista, Monument Kombëtar i Kolorados. Lumi i Arkansasit konsiderohet gjerësisht si destinacioni më popullor në SHBA, dhe mënyra më e mirë për të përjetuar madhësinë e kampionit është rafting. Karvani i gomeneve në lumë prej më shumë se 110.000 në vit dhe peshkatarët që shkojnë aty e kualifikojnë si një nga destinacionet më popullore në Amerikë për sportet ujore. Browns Canyon ofron mundësi të shumta re- ➔





← kreative gjatë gjithë vitit edhe për sportistët e kalërim, alpinizmit, ciklizmit dhe entuziastët e natyrës. Monumenti gjithashtu ka një habitatat të rëndësishme për delet "big-horn", drerët, mushkat dhe shumë lloje të tjera të kafshë të egra. Rafting ishte një eksperiencë për t'u përjetuar.

Si një person që tashmë prej 15 vitesh merresh me këtë sport në Shqipëri, besoj e ke parë edhe me syrin kritik, qoftë për mirë apo edhe për keq; na trego disa detaje nga kjo eksperiencë...

Nuk kisha si t'i shpëtoja kësaj. Më vinte natyrshëm po aq sa rrëtimi në kanyon. Madje guida aty më tha që të qëndroja të punoja me ta pasi kisha aftësi të habitshme të njohjes së lumit. Ai ende nuk e dinte se kam 15 vjet që shpenzoj kohën time më cilësore në lumë (qesh). Mendoj se sfida e tyre më e madhe, duke unisur nga fakti që në sezonin pranverë-verë zbrisin rreth 400 gomone në ditë në lumë, është rreziku i komercializimit të tepërt. Këtë gjë e kam diskutuar edhe me Zamon dhe skuadrën time. Pika jonë e fortë, përveçse bekimit nga natyra me një kanyon shumë unik si Osumi dhe lumë të egër si Vjosa, është shpirti i skuadrës. Ne përpiqemi t'u japim turistëve gjithë dedikimin e mundshëm për t'ua bërë udhëtimin e tyre të paharruar, duke përcjellë me qëndim vlerat e shpirtit shqiptar. Nuk duhet ta humbasim këtë gjë, pasi nuk gjendet shpesh në kompanitë e tjera. Turizmi nuk është vetëm tregti. Ai është pasion dhe përkujdesje për të ndarë me vizitorin kohën e tij më cilësore dhe të gëzuar, pushimet. Ne jemi shumë më të vëmendshëm ndaj

miqve të rafting dhe mendoj se eksperiencat tona janë më të personalizuar, duke i bërë përjetimet e turistëve më të forta.

A i prezantove kanyonin e Osumit atje?

Unë pata privilegjin me ndihmën e "Adventure Travel Trade Association" të tako-

E pashë këtë projekt dhe mendova që ka një potencial të llahtarshëm për të qenë një destinacion i nivelit botëror. Ju inkurajoj t'ia njihni vlerën dhe pasurinë dhe ta mbroini dhe kompanitë dhe organizatat operative në mënyrë që pas 20



ja presidentin e njëres prej kompanive pioniere të rafting aty, që operonte prej 1983, Chuck Cichowitz. Patëm një bisedë të thelluar në lidhje me standardet më të mira për t'u zbatuar dhe modelin e suksesshme për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit. Një pjesë të madhe të kohës e zuri dhe biseda mbi "Albanian Adventure Resort" dhe prezantimi i potencialeve turistike shqiptare.

Cila ishte përshtypja e tij?

Pasi u njoh me produktin e rafting në Shqipëri dhe me projektin e "Albanian Adventure Resort", ai tha: "Jam shumë i emocionuar në përshtypjen time të parë. Projekti është shumë progresiv dhe e vlerësoj si një oportunitet të rëndësishëm nga perspektiva e një personi të huaj. Unë kam udhëtuar shumë në SHBA dhe në botë.

viteve gjithçka të jetë e qëndrueshme dhe reputacioni i aktiviteteve rekreative dhe natyrë dhe rafting dhe Shqipëria të jetë një nga vendet ku njerëzit duan të shkojnë. Çfarë eksperiencë e jashtëzakonshme, shumë profesionale, shumë njerëz miqësor si kjo vajzë e re, ju jeni njerëz të mrekullueshëm në Shqipëri dhe bukuritë e pabesueshme të pasfrytëzuara. Kur pashë fotot e ujëvarave të njerëzve pranë lumit të cilët po argëtoheshin, mendova: Oh, Zot, kjo është e pabesueshme! Prandaj ju inkurajoj të mendoni thellë rreth resurseve tuaja dhe si doni të jeni pas 15-20 vitesh, sepse ai vend do të vazhdojë t'ju sjellë njerëz nga e gjithë Europa dhe SHBA, sa do thonë që është një nga vendet që duam të shkojmë dhe ta përjetojmë. Pra mendimi im është që ka

një potencial të pabesueshëm. Mendohuni mirë dhe jini proaktivë për të dhe mendoj se për 10-15 vite do ndjeni kënaqësinë e pabesueshme të kësaj që keni."

Ju thonë që kanyonin tona janë më të bukura, por si arrinin ata që të thithnin aq shumë turistë?

Besoj se janë 3 faktorë kyç të cilët e kthejnë një vend në destinacion botëror turistik:

1. Mundësitë e bollshme të rekreacionit/aktiviteteve argëtuese. Shqipëria është kaq e bukur, me një kulturë të lashtë, natyrë të paprekur dhe trashëgimi autentike. Ne kemi shumë punë për të bërë për të zhvilluar produktet turistike duke i bërë këto vende lehtësisht të arritshme për turistët dhe plot aktivitetet për t'u argëtuar, por duke pasur një impakt sa më të ulët në mjedis.

2. Aftësia për të rekrutuar dhe mbajtur një fuqi punëtore të shëndetshme, të aftë dhe produktive. Me dhimbje jam dëshmitar e emigrimit të të rinjve çdo ditë nga vendlindja, dhe kjo gjë e kërcënon seriozisht trashëgiminë dhe ekonominë lokale. Duhet të tërheqim praktikantë më të mira për formimin profesional të të rinjve dhe orientimin e tyre dhe të komunitetit drejt një turizmi të qëndrueshëm. Edukimi në turizëm duhet të jetë fuqes për të gjithë të rinjtë që duan të bëjnë një ndryshim pozitiv për Shqipërinë.

3. Një mjedis pro-biznesi dhe paketë konkurruese e taksave. Kostoja e të ofruarit turizëm në Shqipëri duhet të jetë sa më e ulët, në mënyrë që tërhiqen investitorë dhe qeveria duhet të ofrojë incentiva dhe subvencione për start-up-et dhe gjithë personat që kanë marrë guximin të investojnë në një industri të brishtë si turizmi, duke krijuar një ekosistem funksional zhvillim dhe rritjeje në këtë drejtim.

Ju punuat në një kompani atje; si funksiononte puna?

Unë pata kënaqësinë të punoja në praktikë pranë kompanisë "Galvanize", në Denver, e cila nxiste krijimin e start-up-ëve të reja, mbështeste suksesin e tyre nëpërmjet investimit në infrastrukturë e dije mbi zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe inovacionit. Kam pasur mundësinë të takoj mentorë dhe profesionistë të shkëlqyer, me të cilët u angazhova në çështje si mbledhja e fondeve, menaxhimi financiar, e deri te strategjitë e markës dhe promovimit.

Me aq sa patë në SHBA, besoj ke arritur në disa konkluzione për zhvillimin e turizmit në Shqipëri?

Volum i ulët dhe më vlerë të lartë. Kështu duhet të jetë turizmi në Shqipëri. Pas zgjimit të kuriozitetit të gjithë botës për Shqipërinë, na takon tani të tërheqim "turistët me vlerë të lartë" - vizitorët që do të qëndrojnë

më gjatë dhe do të shpenzojnë më shumë se mesatarja e turistëve edhe për faktin që ata vijnë gjatë periudhave të sezonit të ulët të fluksit të turistëve dhe janë të pritur të eksplorojnë destinacione më pak të populluara.

Pse thonë që duhet t'i mësojmë turizmit të lukstit; nuk mendon se të huajt vijnë te ne vetëm sepse jemi një vend i lirë?

Tërheqjet kryesore turistike të Shqipërisë janë kultura dhe mënyra e jetës së saj tradicionale, monumentet kulturore dhe natyra e pacenuar. Ne i kemi të gjitha. Nuk ka nevojë të jemi modestë në këtë pikë. Kemi mundësinë e artë të ofrojmë një produkt të diversifikuar. Turistët na pëlqejnë dhe vlerësojnë sepse jemi ndryshe nga pjesa tjetër e botës dhe kemi zakone të trashëgimi njerëzore të pasur. Mbrojtja e natyrës dhe kulturës duhet të jetë pjesë e sistemit të vlerave shqiptare si një aspekt i rëndësishëm i ruajtjes së mënyrës tradicionale të jetës në Shqipëri. Në këtë sezon turistik, jemi të vetëdijshëm se një rrjedhë e pakufizuar e turistëve pengon mbajtjen pastër të mjedisit dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Strategjia afatgjatë e Shqipërisë duhet të jetë një turizëm i kontrolluar me fokus në qëndrueshmërinë dhe cilësinë duke siguruar reputacionin e vendit si një destinacion ekskluziv dhe i veçantë, me një kontribut të rëndësishëm në ekonominë lokale. Qëllimi i qeverisë duhet të jetë maksimizimi i të ardhurave në valutë të huaj duke minimizuar ndikimet e mundshme negative kulturore dhe mjedisore të turizmit dhe duke siguruar shpërndarjen e të ardhurave në komunitet.

Çfarë do të "vjedhësh nga Amerika për ta zbatuar në Shqipëri?

Shembullin e suksesit në zhvillimin e sipërmarrjeve të reja. Është biznesi ai që zhvillon ekonominë dhe përmirëson shoqërinë. Sipërmarrësit ngrinë biznese që hapin vende të reja pune. Janë ata që paguajnë taksat. Një sipërmarrje e re ka nevojë për burime që të krijohet, dhe kështu aktivizon edhe bizneset e tjera gjatë procesit. Janë sipërmarrësit e rinj ata që sjellin teknologjitë reja dhe zgjidhje inovative në treg. Sipërmarrësit stimulojnë ekonominë duke rritur besimin të njerëzve. Shëndeti ekonomik i një kombi në përgjithësi varet nga performanca e PBB-së së saj (Produkti i Brendshëm Bruto). Duke pasur një ekonomi të shëndetshme, i bën njerëzit të sigurt për të investuar, jetuar dhe punuar në vend edhe në kohët e recesionit.

Shumë shqiptarë zgjedhin që të largohen nga vendi i tyre. Ti ishe atje; do e ndërroje Shqipërinë me Amerikën?

Besoj se Amerika është

shembulli në botë ku demokracia dhe shteti i së drejtës funksionojnë më së miri. Ekonomia aty është e shëndetshme dhe niveli i jetesës cilësor. Këto dhe shumë arsye të tjera i detyrojnë shumë shqiptarë të emigrojnë. Kurse unë mendoj se vendi im është Shqipëria, për faktin se këtu është vendlindja ime, toka ime, familja ime. Është e paparashikueshme por plot sfida. Këtu kam fatin e madh të punoj dhe të bëhem pjesë e një ndryshimi. Të shoh zona të harruara që rilindin, të punoj me të rinj duke ngjallur shpresat dhe entuziazmin për një të ardhme më të mirë, të takoj njerëz të jashtëzakonshëm në zona të thella dhe të varfra, por me një zemër të madhe. Nuk është e lehtë, sigurisht, por kudo ka sfida. Shqipëria më motivon, më plotëson shpirtërisht, më jep mundësinë të ndihem e dobishme. Besoj është detyra e çdo njeriu të kontribuojë për vendlindjen. Kjo është mënyra ime.

Mendon se e ardhmja e Shqipërisë duhet të mbështetet edhe në turizëm?

Për një vend të vogël me dalje në breg, male të thepisura, burime ujore të brendshme të panumërta si Shqipëria, turizmi duhet të luajë rol shumë të rëndësishëm në krijimin e mundësive dhe të ardhurave për punësim dhe paralelisht të garantojë ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, njerëzore dhe natyrore. Dhe, që të arrihet kjo, kemi nevojë për turistë cilësorë, të cilët janë të gatshëm për të paguar për eksperiencë unike dhe për impaktin sadë të vogël që lënë në mjedis.

Nuk je lodhur ndonjëherë nga kjo punë?

E dua këtë që bëj dhe pasioni e entuziazmi nuk më lënë asnjëherë të lodhem. Dua t'u them të gjithëve që kanë një ëndërr; na ndjekin atë. Puna do i nxjerrë gjithmonë në sipërfaqe. Mos i letoni askujt t'ju tregojë se nuk jeni mjaft të mirë apo se ideja juaj nuk vlen. Qëndroni të vërtetë dhe mos u lodhni së përmirësuarit veten tuaj. Jeta është një udhëtim me ulje dhe ngritje, përqafoni më të mirën rreth jush, mësoni nga gabimet tuaja dhe bëhuni pjesë e ndryshimeve pozitive për veten, familjen dhe vendin tuaj. Kjo ka rëndësi. Faleminderit atyre që më kanë frymëzuar që të kem guxim të arrij deri këtu. Të gjithëve atyre që më kanë mbështetur dhe ndihmuar i premtroj se s'kam për të reshtur asnjëherë së ndjekuri ëndërrat e mia dhe nuk do dorëzohem derisa t'i shoh ato të bëhen realitet.

NJOFTIM

Pranë zyrës përmirësimit të shoq. "tebest" shq. adresa: Rr. "D.Hoxha" nr 915, Tirane. zhvillimi/ankand/ hapur me datën 11/10/2017, ora 15.30. Pasqelë në shprehje: Jane I.Pas. Inuali me nr 70/02.10.025-5447m2 Nr regjist.11.1q.144 dhe pas. nr 70/4.2K.1042.5-447m2 m2 Nr regjist.11.1q.24. Zk.1042.5-5447m2 m2. adresë fshati Aramerars Xhaxho vlera lilestara -55083000.

Të interesuarit le paraqiten me adresën: Rr. "D.Hoxha" nr 915, Tirane. tel: 673019849; email: tebest@gmail.com

Efektivë të Komisarit Nr. 2 në Tiranë kanë vënë në pranga një 28-vjeçar i cili akuzohet se ka plagosur me thikë një djalë 3 vite më të vogël se ai. Burime pranë uniformave blu sqaruan se shërbuesit mes tyre ka nisur në një lokal nate në zonën e ish-Bllokut. Mësohet se i plagosur ka mbetur 25-vjeçari me inicialet E.S., që ka marrë një plagë në bark, i cili fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Si autor të dyshuar të krimit, policia arrestoi 28-



Policia arreston në flagrancë autorin 28-vjeçar

Sherri për një femër në lokal e natës në ish-Bllok, i riu plagoset me thikë në bark

vjeçarin E.D. Ngjarja në fjalë ka ndodhur gjatë orëve të para të mëngjesit të së shtunës, në një lokal nate. "Në datën 30.09.2017, u arrestua në flagrancë shtetasi E. D., 28 vjeç, banues në Tiranë, pasi rreth orës 03:15, tek ish-Blloku, te një lokal, në bash-

këpunim me disa persona të paidentifikuar, pas një konflikti për motive të dobëta, ka gjuajtur me thikë në bark, shtetasin E.S., 25 vjeç, banues në Tiranë, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Puno-

het për identifikimin dhe kapjen e shtetasve të tjerë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Menjëherë pas ngjarjes së rëndë, i plagosuri u dërgua në spital për të marrë ndihmën e nevojshme. Me t'u sinjalizuar për plagosjen e ndodhur, policia mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes dhe nisi punën për

zbardhjen e plotë të rrethave të krimit, si dhe për të zbardhur shkaqet e plota të konfliktit të ndodhur mes tyre. Nga veprimet e para hetimore, burimet e policisë bënë me dije se autori dhe i plagosuri kanë qenë në tavolina të ndryshme, por shumë pranë njëra-tjetrës. Ndonëse 28-vjeçari i plagosur nuk ka dhënë detaje për atë që ndodhi, policia ka dyshime se konflikti mes tyre kishte ndodhur për një femër, ndërsa dy të rinjtë kanë qenë nën efektin e alkoolit.

I afërmi i viktimës nga aksidenti: Në 2013 ka marrë mbi 27 mln lekë

Arrestohet avokati, mashtroi familjarët e të ndjerit për dëmshpërblimin

Myrteza Myftari akuzohet për 2 vepra penale

Xhensila Kodra

Një avokat 56-vjeçar nga Tirana ka përfunduar në prangat e policisë së kryeqytetit pasi akuzohet se ka mashtruar familjarët e viktimës së një aksidenti të ndodhur 4 vite më parë, duke mos u dhënë atyre dëmshpërblimin për dëmin shëndetësor. Burime zyrtare të policisë bënë dije me dije se i arrestuari është Myrteza Myftari, 56 vjeç, banues në Tiranë. Sipas policisë, vënia në pranga e avokatit u bë, pasi ndaj tij është bërë kallëzim nga familjari i viktimës se nuk i është dorëzuar asnjë shumë parash për dëmin e shkakuar. "Ky shtetas është arrestuar, pasi shtetasi M.S., ka bërë kallëzim në ambientet e Policisë Tiranë, ku deklaroi se shtetasi Myrteza Myftari, me profesion avokat, më datë 02.05.2013, ka marrë një shumë prej 722 424 lekësh të reja, si dëmshpërblim për dëmin shëndetësor me pasojë vdekjen për shtetasin F.R., shumë të cilën nuk ia ka dorëzuar familjes të së ndjerit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



Avokati Myrteza Myftari

KALLËZIMI

Kallëzimi në policinë e Tiranës është bërë nga familjarët e viktimës me inicialet F.R. Pas kësaj, nga hetimet dhe verifikimet e kryera ka rezultuar se familjarët e të ndjerit janë shpërblyer nga kompania e sigurimit me një

shumë prej 27 milionë lekësh të vjetra. Por sipas kallëzimit të tyre, këto para, avokati nuk ua ka dhënë asnjëherë. Menjëherë pas kallëzimit të marrë, blutë e kryeqytetit nisën hetimin për të zbuluar edhe vërtetësinë e këtij rasti. Pas verifikimeve të

bëra, burimet e policisë sqaruan se pretendimet se dëmshpërblimi që u takonte familjarëve të të ndjerit me inicialet F.R., nuk u është dhënë nga avokati, janë të vërteta. Pas kësaj, mesditën e së shtunës, Policia e Tiranës bëri të mundur edhe

ARRESTIMI
Vënia në pranga e avokatit Myrteza Myftari u bë menjëherë pas kallëzimit që familjarët e viktimës së një aksidenti të ndodhur në vitin 2013 bënë ndaj tij, pasi dyshonin se paratë që u takonin për dëmshpërblim

vënien në pranga të 56-vjeçarit Myrteza Myftari. Ndaj këtij të fundit rëndojnë dy akuzat; ajo e shpërdorimit të detyrës dhe për mashtrim. Ndërsa materialet në ngarkim të tij u referuan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Tiranës.

SHKURT

Aksidenti, vdes 1 grua, tjetra rëndë në spital

MALIQ - Një aksident me pasojë vdekjen e një 65-vjeçareje ka ndodhur dje, në fshatin Podgorie. Burime zyrtare nga policia e Korçës bënë me dije se shtetasi me inicialet J.K., teksa drejtonte mjedin tip "Nissan" me targa NZY-7994, ka aksidentuar shtetasen S.C., 65 vjeçe dhe B.Xh., 70 vjeçe, banuese në Podgorie, kalimtare në rrugë. Menjëherë pas ngjarjes, dy të plagosurat janë transportuar në Spitalin e Pogradecit për ndihmë mjekësore, ku shtetasja S.C., pak minuta pas mbërritjes ka ndërruar jetë, ndërsa B.Xh. aktualisht ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Drejtuesi i mjedit u shpërndo në ambientet e komisariatit për veprimet të mëtejshme.

Kërkohej për vrasje në Greqi, kapet vlonjati me 2 emra

VLORE - Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë kanë arrestuar një të shumëkërkuar për vrasje. Ai është Juljan Dautaj ose siç njihet ndryshe Mikel Serjanaj, 40 vjeç, banues në Vlorë. Ndaj këtij shtetasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me Vendim Penal Nr. 339, datë 23.09.2017, i ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest në burg", për veprën penale "Vrasje me dashje". Ngjarje e ndodhur më datë 27.11.2001, në vendin e quajtur "Kali thea", Athinë, Greqi, ku Juljan Dautaj ka vrarë me mjete të ftohta prerëse (thikë) shtetasin K.P. Materialet i janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprimet të mëtejshme.

Policia referon 40 raste të Krimit e Rënda

Operacioni "Vjeshtë 2017", në 1 muaj sekuestrohet pasuri me mbi 50 mln euro

Në vetëm 1 muaj që nisja e operacionit "Vjeshtë 2017", për goditjen e grupeve dhe asetëve kriminale, Policia e Shtetit ka referuar materiale në prokurori për hetime pasurore për 44 raste, nga të cilat 40 janë dërguar në Prokurorinë për Krime të Rënda, e 4 referime në prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Berat, Tiranë e Fier. Sipas burimeve, bëhet fjalë për pasuri, që nëse do të sekuestrohen, vlera financiare mund të kalojë shifrën e 50 milionë eurove.

Operacioni

Policia e Shtetit ka referuar materiale në prokurori për hetime pasurore për 44 raste, nga të cilat, 40 janë dërguar në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe 4 referime në prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Berat, Tiranë e Fier.

"Top Channel" ka siguruar të dhënat e pasurive të dyshuara që janë evidencuar. Në listën e uniformave blu renditen 79 apartamente banimi dhe vila, 25 njësi tregtare, 84 automjete, një pallat 11-katësh, dy anije peshkimi, si dhe rreth 54 mijë metra katrorë sipërfaqe toke. Në vetëm një rast në qytetin e

Lezhës, gjykata ka aprovuar kërkesën e prokurorisë, pas referimit të saj, duke sekuestruar pasuri në vlerën e 670 mijë eurove të një individi me të shkuar kriminale në disa vende të Bashkimit Europian. Operacioni "Vjeshtë 2017" nuk ka një afat të paracaktuar, thonë burime nga policia, ndaj pritet që të vi-



Policia gjatë aksionit

jojë deri në fund të vitit dhe synon të arrijë shifra rekord në historinë e viteve të fundit, sa i takon vlerën së pasurive të sekuestruara. Por, problem mbetet hallka tjetër, konfiskimi përfundimtar i asetëve për llogari të shtetit.

Nga eksperiencia e viteve të fundit, në shumicën e rasteve, si pasojë e zvarritjes së proceseve, por edhe manovrave ligjore, individëve iu kthehen pronat, pasi nuk arrihet të vërtetohet burimi kriminal.

ITALI - Një sherr banal për motive të dobëta ka ndodhur mbrëmjen e së shtunës në Itali, ku protagonist ka qenë një i ri shqiptar. 29-vjeçari është arrestuar nga policia italiane pas një sherrri që ka zhvilluar me një shtetas italian. Mediat e huaja raportuan dje se grinda që ka nisur për motive banale ka degjeneruar deri në dhunë fizike. Ngjarja ka ndodhur gjatë natës në një pub në Tovo San Giacomo, ku 29-vjeçari sh-



Arrestohet shqiptari, plagosi punonjësin e një pub-i për motive të dobëta

qiptar ka pasur me vete një çelës, me të cilin ka goditur italianin 22-vjeçar në sy. Ky i fundit ishte punonjësi i pub-it. I plagosuri i dërgua menjëherë në spital dhe pas një ndërhyrjeje kirurgjikale, mësohet se është arritur t'i shpëtohet syri. Shqiptari Dritan Hasani, banor në Finale Ligure, u arrestua nga stacio-

ni policor i Finale menjëherë pas aktit të dhunës. Por, ky nuk është rasti i parë ku një shtetas shqiptar përfshihet në incidente me pasoja të rënda. Para pak muajsh një ngjarje tjetër për motive të dobëta u shënuar në Itali, ku ishin të përfshirë në sherr dy shqiptarë me një maroken. Mediat italiane bënë me dije

se ngjarja kishte ndodhur në "Sheshin e Dëshmorëve", ku shqiptarët pas sherrit verbal me marokenin, kishin filluar të konfrontoheshin edhe fizikisht me të. Marokeni është rrahur nga shqiptarët në parkun "Allea", ndërsa ai kishte mundur që të shpëtonte duke u ikur atyre. Por, ai ishte vënë re pak metra

më tutje nga një italian, mik i shqiptarëve, ku edhe ai ka filluar ta godasë, duke e lënë të plagosur të riun. Pasi në vendin e ngjarjes kishte shkuar policia, i riu maroken ishte shoqëruar për në spital për të marrë ndihmën e parë mjekësore, pas goditjeve që kishte marrë nga shqiptarët dhe italian. Por historia nuk mbaron këtu, pasi marokeni është takuar në dhomën e emergjencës me shqiptarët, duke qenë se edhe njëri prej tyre ishte i plagosur.

Ngjarja në "Saint Charles", nga sulmi me thikë mbetën të plagosur disa kalimtarë të tjerë

Egla Xhemali

FRANCË

Një ngjarje e rëndë që ka përfunduar me tri viktima ka ndodhur pasditën e së dielës në Francë. Një person teksa mbante një thikë në dorë e duke thirrur "Allahu Akbar" vrau dy kalimtare femra, ndërsa vetëm pak minuta më vonë u qëllua për vdekje nga ushtarët në stacionin hekurudhor kryesor të Marsejës, në jug të Francës. Sulmi ka ndodhur në stacionin "Saint Charles", ku shumicën e kohës është plot me njerëz, ndërkohë që zona është e rrethuar nga forca të shumta policore. Personi i armatosur ka vrarë me thikë dy kalimtare, bëri me dije prefektura lokale. Të dyja viktimat janë femra, njëra nga Sgozzata, tjetra nga Pugalata. Autori i ka prerë një pjesë prej tyre fytyrën, ndërsa tjetra është goditur në stomak. Fatqësisht, ato nuk kanë mundur t'u mbijetojnë goditjeve që kanë marrë e për pasojë kanë ndërruar jetë. Nga zyra e prokurorit në Paris dhe nga autoritetet në deklaratë se kjo është një vrasje e lidhur me terrorizmin. "Daily Mail" publikoi edhe dy foto nga vendngjarja ku duken dy viktimat të shtrira në tokë, pak metra larg njëra-tjetrës. Sulmuesi gjithashtu nuk është ndaluar. Ai ka plagosur edhe persona

Terroristi vret 2 gra në stacionin hekurudhor, njëriës i pret fytyrën, tjetrën e qëllon në stomak

Atentatori thërriste "Allahu Akbar", u vra nga policia



të tjerë. Ministri i Brendshëm, Gerard Collomb do të udhëtojë menjëherë drejt Marsejës, lajmëroi zyra e tij. Policia ka evakuuar stacionin duke bllokuar hyrjedaljet për të mos pasur trazira të tjera. Ndërkohë, vetëm pak minuta më vonë, teksa forcat policore franceze ishin vënë në ndjekje të au-

shmangnin zonën. Të tjera tentativa me bazë sulmin terrorist e kanë përfshirë kryeqytetin e Francës ditët e para të gushtit, ku 6 ushtarë u plagosën. 2 prej të cilëve në mënyrë serioze, pasi u përplasën nga një automjet në periferinë "Levallois-Perret". Incidenti u pasua nga një operacion i madh policor për gjetjen e agresorit dhe automjetit të përfshirë në ngjarjen e ndodhur. Kryebashkiaku lokal, Patrick Balkany deklaroi se nuk kishte dyshime se bëhej fjalë për një akt të qëllimshëm ndodhur në "Place de Verdun", jo shumë larg bashkisë. Sipas tij, një automjet i tipit "BMW" kishte shtuar shpejtësinë, duke përplasur një grup ushtarësh të operacionit antiterrorist "Sentinelle", para se të largohej. Hetuesit njoftuan se po marrin në konsideratë çdo lloj piste, përfshirë atë të terrorizmit.

SULMET NË FRANCË

Mars 2012 - Një algeriano-francez vrau 3 ushtarë, një mësues dhe 3 studentë të rinj, në një shkollë hebraike në Tuluzë. Ai më vonë u vra nga policia gjatë një bastisjeje në apartamentin e tij.

23 maj 2013 - Një person i konvertuar në mysliman, i quajtur Alexandre Dhaussy, theri një ushtar francez në fytyrë, pranë "La Defense" në Paris. Ushtri i mbijetoi sulmit.

Dhjetor 2014 - "Joue-les-Tours": një francez i lindur në Burundi sulmoi disa oficerë policie me thikë, duke thirrur "Allahu Akbar". Ai plagosi 3 oficerë, përpara se të qëllohej për vdekje.

7 janar 2015 - Said dhe Cherif Kouachi qëlluan për vdekje 12 persona në zyrat e revistës satirike "Charlie Hebdo", përfshi disa prej karikaturistëve më të njohur të saj.

3 shkurt 2015 - Tre ushtarë gjatë patrullimit jashtë një qendre komunikative hebreje në Nisë u sulmuan nga një person i armatosur. Ai i theri njërit prej tyre krahun, ndërkohë që i preu fytyrë një tjetri përpara se të arrestohej.

Korrik 2016 - Adel Kermiche, 19-vjeçar, dhe Abdelmalik Petitjean, sulmuan një kishë në Normandi gjatë orëve të para të së martës dhe i prenë fytyrën Jacques Hamel. Të dy djemtë, siç i kanë quajtur "ushtarët" gjatë sulmit në kishë, kishin marrë peng tri murgës.

9 gusht 2017 - Kryeqyteti francez dridhet nga frika e një tjetër sulmi të mundshëm terrorist. Të paktën 6 ushtarë u plagosën, dy prej të cilëve në mënyrë serioze, pasi u përplasën nga një automjet në periferinë "Levallois-Perret". Incidenti u pasua nga një operacion i madh policor për gjetjen e agresorit dhe automjetit të përfshirë në ngjarjen e ndodhur mëngjesin e së mërkurës. Kryebashkiaku lokal, Patrick Balkany tha se nuk kishte dyshime që bëhej fjalë për një akt të qëllimshëm.

Dëmtohen edhe 12 policë

Referendumi në Katalonjë, plagosen mbi 700 persona

KATALONJË - Referendumi për pavarësinë e Katalonjës është shoqëruar me incidente, ku ka pasur edhe përplasje mes banorëve dhe policisë spanjolle. Raportohet se më shumë se 700 persona u plagosën në përleshjet me policinë. Ndërsa u dëmtuan edhe 12 policë. Mediat raportojnë se forcat e dërguara nga Madridi kanë hyrë me furi në një nga qendrat e votimit në Girona. Ata shihen tek thyenë xhamin e derës kryesore

të shkollës e cila po shërbente si qendër votimi të Sant Julià de Ramis. Më pas forcat policore vazhdojnë një kontroll të dhunshëm në ambientet e shkollës, ndërkohë që votuesit, shumica e të cilëve mendohet ta kenë kaluar natën aty, fillojnë të bërtasin në kor. Zyrtarët spanjollë urdhëruan policinë që të mbyllin shkollat në rajon, të cilat ishin të përgatitura si vendvotime, e që janë planifikuar të hapen në mëngjes të ditës së sotme. "Associated Press" bën me dije se, pavarësisht kërcëni-



meve, kutitë e votimit janë parë duke arritur në qendrat e votimit, dhe qeveria e Katalonjës tha se do të lejojë që fletëvotimet të shtypen në shtëpi, që të përdoren nga votuesit. Shumë përkrahës të referendumi kanë fjetur dhe qëndruar në shkolla, për të mbajtur vendet e hapura deri në fillim të votimit.

Roli i tyre, të ushtrojnë detyra vëzhguese

Danimarka vendos ushtarë të armatosur në kufirin me Gjermaninë

DANIMARKË - Të gjithë njerëzit që kalojnë kufirin nga Gjermania në Danimarkë do të ndeshen tashmë me imazhin e ushtarëve të armatosur. Një propozim i ri i Bashkimit Evropian parashikon po ashtu që kontrollet kufitare mund të shtohen. Danimarka vendosi të premtën ushtarë të armatosur në kufirin me Gjermaninë. Synohet që ushtarët të përforcojnë kontrollin e policisë, që janë akoma në veprim në kufirin me landin gjerman të Schleswig-Holsteinit afër qytetit të Flensburg. Kontrollin në kufi filluan në janar 2016, në kuadër të fluksit të refugjatëve në Evropë. Zyrtarët danezë thanë, se ushtarët e rinj do



të veprojnë në sfond dhe nuk do të marrin pjesë direkt në kontrollin e makinave. "Roli i tyre kryesor është të ndihmojnë të transportohen të dyshuarit dhe të ushtrojnë detyra vëzhguese", tha për reporterët Brian Fussing, nga njësisia speciale e policisë kufitare të jugut të Jutlandit. Ushtarët do të dislokojnë fillimisht për tre muaj. Ata nuk do të dislokojnë në terminalin e trageteve të Rodby dhe Gedser. Në fillim të javës, Bashkimi Evropian propozoi një zgjerim të kontroleve të deritanishme të përkohshme në kufijtë e brendshëm të territorit të BE-së, duke synuar sigurinë. Liria e lëvizjes është principi kyç i projektit evropian.



Pavarësisht tipologjisë së divorcit "i lehtë" apo "i vështirë", në çdo rast duhet marrë në konsideratë çdo reagim i fëmijës gjatë këtij procesi, në mënyrë që çdo problem i mundshëm të trajtohet në kohë

Graciela Mana *



Vëmendje ndaj fëmijëve që përjetojnë divorcin e prindërve

Divorci i prindërve është një lloj traume për fëmijët në të shumtën e rasteve, por jo gjithmonë fëmija shfaq shenja të dukshme apo jep sinjale të qarta për eventin traumatik që po përjeton, ndaj është e nevojshme t'u rikujtojmë prindërve, të afërme, mësuesve e edukatorëve të jenë të vëmendshëm, vëzhgues e raportues të sjelljeve apo qëndrimeve të ndryshuara sado të vogla të jenë ato. Zakonisht raportohen vetëm ndryshimet e mëdha apo sjelljet problematike që shfaq fëmija me të tjerët e që janë të vështira për t'u menaxhuar, ndërkohë që pa dashje apo nga mungesa e informacionit neglizhohen ndryshime të sjelljes, në të cilat fëmija reagon me më pak "zhurmë" për sytë e të tjerëve. Të gjithë personat që janë në kontakt me fëmijën që po përjeton situatën e divorcit të prindërve të tij



met. Përsa i përket problematikës së ndërveprimit me të tjerët, një pjesë e konsiderueshme e tyre, kur i rikthehen dhe interpretojnë historinë e tyre, i referohen ngjarjes së divorcit të prindërve si fillesa e këtij problemi. Por, nga ana e profesionistëve duhet pasur kujdes, pasi vetëm në rastet kur është e vështirë të kuptohet se pse individ i kryen sjellje të caktuara dhe koha kur ka filluar shfaqja e sjelljeve, pavarësisht nga ashpërsia e tyre, përkon me periudhën e divorcit të prindërve, vetëm atëherë mund t'i referohemi drejt-përdrejt divorcit si dëmtuesi i funksionimit të fëmijës. Një pjesë e rasteve të çrreg-

ullimit të ankthit të ndarjes dhe varësive u delegohen pasojave të divorcit të prindërve kur fëmija ka qenë në moshë të vogël. Fëmija ka nevojë të marrë vëmendje nga të dy prindërit dhe në rastet kur kjo vëmendje mungon në mënyrë të vazhdueshme, fëmija mund të ndjehet i refuzuar, të krijojë mbindjeshmëri dhe të reagojë fort në situata sociale në të ardhmen, që kanë të bëjnë me refuzimin. Gjithashtu, mund të zhvillojë vetëvlerësim të ulët dhe pritshmëri negative përsa u përket marrëdhënieve intime varësisht të kaluarës së tij. Rastet e shfaqjes së agresionit të ashpër tek fëm-

ijët si pasojë e divorcit janë të rralla, por është e rëndësishme të menaxhohen e trajtohen në kohë për të shmangur pasoja të tjera në kosto shumë më të mëdha, që mund të vijnë si shkak i akumulimit të emocioneve negative. Zakonisht individit e shfaq agresionin si përgjigje ndaj divorcit në rastet kur i bën prindërit përgjegjës për vuajtjen e tij dhe më pas e zhvendos agresionin tek të tjerët. Pavarësisht kësaj, është e vështirë të parashikohet sjellja e dhunshme. Nëse një pjesë e fëmijëve pas divorcit të prindërve vazhdojnë të ndërveprojnë, të krijojnë miqësi të ngushta dhe ta kalojnë pa problem situatën

e divorcit të prindërve të tyre, një pjesë tjetër e përjeton si diçka thellësisht traumatike, pasi mënyra sesi kanë rrjedhur ngjarjet deri në procesin e divorcit mund të ketë qenë e tillë në vetvete. Pavarësisht tipologjisë së divorcit "i lehtë" apo "i vështirë", në çdo rast duhet marrë në konsideratë çdo reagim i fëmijës gjatë këtij procesi, në mënyrë që çdo problem i mundshëm të trajtohet në kohë, duke minimizuar kështu pasojat afatgjata dhe pritshmëritë negative që mund të zhvillojë fëmija në të ardhmen, në raport me veten dhe të tjerët.

***Psikologe klinike, terapistë EMDR**



“KURTHET E DRITERO AGOLLIT” PJESA E GJASHTE

HOMAZHET PËR SHKRIMTARIN POGRADECAR

Ilir Bushi

Një sherr i pazakontë për Lasgush Poradecin ka ndodhur mes dy shkrimtarëve, Agollit e Kadaresë, e kjo për pensionin e tij. Ramiz Alia dhe sëra e tij nuk e donte, ndërsa Mehmet Shehu votonte pro. Kjo situatë u zhvillua edhe mes shkrimtarëve, të cilët kishin opinione pro e kundër: Dritëroi, atëherë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, nuk u prononcua për homazhet që e bija e shkrimtarit pogradecar kërkoi, po si u justifikua shkrimtari. Në librin e Ilir Bushit ne njohim një pjesë të historisë së panjohur për ne.


Një sherr tjetër midis Agollit e Kadaresë ka ekzistuar edhe për dhënien e pagesës si shkrimtar i lirë, për Lasgush Poradecin, ku Mehmeti ishte pro, ndërsa Ramizi ishte kundër. Në fakt, duhej të kish ndodhur e kundërta, sepse Mehmeti, si kryeministër i Shqipërisë, duhej të mbronte ligjet që kish firmosur vetë, ku thuhej se, “pasi mbush moshën, krijuesi del në pension dhe nuk përfiton pagesën e shkrimtarit në profesion të lirë”. Por, nëse puna e tij vlerësohej si e domosdoshme, atëherë shteti i paguante pension special. Kjo pikë ishte e qartë, por në këtë pikë jo vetëm krijuesit e mëdhenj, Kadare e Agolli ishin kundër njëri-tjetrit, por edhe byroistët ishin në gjykim kundërshtues. Mehmeti ishte pro, ndërsa Ramizi, kundër: Pa llogaritur këtu Kadri Hazbiun, Hekuran Isain etj., që ishin kundër çdo privilegj për shkrimtarët.

Dritëroi kërkonte zbatim të ligjit dhe rregulloreve përkatëse, ku thuhej se shkrimtarët që mbushin moshën e pensionit nuk përfitojnë pagesën e krijuesit në profesion të lirë. Ndërsa, ata që janë të spikatur me krijimtarinë, pas mbushjes së moshës përfitojnë pension special nga shteti. Pra, pensioni special jepej me urdhër të kryeministrit Mehmet Shehu, por ata kërkonin që Lasgushi të mund të lejohej të merrte pagesën e shkrimtarit në profesion të lirë. Ndërkaq, në Lidhjen e Shkrimtarëve ishin edhe disa shkrimtarë e skulptorë, të tjerë, që kishin mbushur moshën e pensionit dhe kërkonin pagesën e profesionit të lirë si Fatmir Gjata, Odhise Paskali, etj., etj.

Dritëroi thoshte: Sipas ligjit, profesioni i lirë dhe lekët e pagesës jepeshin derisa të mbushej moshja e pensionit. Pastaj, shkrimtari dilte në pension dhe vetvetiu ishte i lirë. Unë kisha detyrimin të zbatoja ligjin. Për këtë pyeta edhe në ministri, por nuk më lanë. Kështu i dhamë një shtesë pensioni. Por Ismaili dhe Bashkim Shehu shkuan dhe u ankuan kundër meje. Unë s'kisha nga të lëvizja kundër ligjit. Se njëherë unë pagova 10 mijë lekë nga xhepi së dhashë urdhër që t'u jepeshin falas revistat shkrimtarëve dhe më në fund m'i lanë ato në ngarkim. Ç'të bëja më shumë? Unë e doja Las-

Vdekja e Lasgushit, replikat e familjes me Dritëroin: S'mund të dilja mbi ligjin

"Ismail Kadare dhe Bashkim Shehu shkuan dhe u ankuan kundër meje"



babait, trupin tim edhe të vdekur, ta shpesh në Pogradec", i thotë ai vajzës, që i qëndron tek koka. Dhe pasi heshti pak, e pyeti: "Po a ke lekë ti, bijë e babkës, të më varrosësh mua atje?". Ja, se si vdisnin poetët në atë kohë, kur pas një pune vetëmohuese, në fund nuk kishin as lekë që të varroseshin.

Ndërsa, kur vdiq aktori dhe regjisori Kujtim Spahivogli, më 7 korrik 1987, shoku i tij i ngushtë, Ferdinand Radi, shkoi në shtëpinë e Dritëroit dhe trokiti në derë. Sipas, Ferdinandit, aty doli një vajzë, që mund të ishte Elona, e bija e poetit. - Aty është Dritëroi? - e pyeti Nandi.

- Jo - iu përgjigj, vajza.
- Mirë, thuaj se Kujtim Spahivogli, vdiq! - i tha Nandi dhe iku, pasi e përshëndeti.

Dritëroi me Kujtim Spahivoglin, dikur kishin qenë shokë të ngushtë, por njëri prej tyre ishte dënuar nga diktatura, ndërsa tjetri ishte bërë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve. Prandaj, në mes ishte një hendek i madh që i ndante dy miqtë, për të mos u takuar kurrë.

MË 1988, VARET NË LITAR POETI

Ky ishte kulmi i barbarisë së një shteti kriminal.

Poeti Havzi Nela u ekzekutua me varje në 10 gusht të vitit 1988, ku si prova të aktakuzës u përdorën edhe disa poezi të tij për lirinë. Më 24 qershor 1988 Gjykata e Lartë e Shqipërisë, e përbërë nga gjyqtarët Fehmi Abdiu, Vili Robo dhe Fatmira Laskaj hodhi poshtë kërkesën për falje të bashkëshortes së Havziut, Lavdije Nelës dhe vendosi që Havzi Nela të dënohej me varje në litar, ndërsa miratimi përfundimtar u bë nga kryetari i presidiumit të Kuvendit, Ramiz Alia. Fjalët e fundit të Havzi Nelës ishin këto: "I keq kam qenë dhe ashtu, po shkoj. Të këqijta e mia, i mora me vetë, kërkoi që të afërmit e mi të trajtohen mirë dhe mos merren nëpër kambë. Kam nëntëqind e dhjetë lekë dhe kërkoi që këto t'u jepjen të afërmit të mi, nanës".

Litari preu në mes ëndrrat dhe shpresat e një poeti, i cili u ekzekutua vetëm se shkruante poezi të lira. Ndoshta, për këtë arsye, Dritëroi Agolli mund t'i dërgonte një copë letër Alisë, për të shmagur ndëshkimin mesjetar. Ose për të treguar para historisë, se ai vetë ishte në krahun e poetëve të lënduar. Por, kjo nuk ndodhi dhe as që mund të ndodhte.

gushin, por ligji ishte dhe mbetet ligj. Unë, atëherë kisha Odhise Paskalin, Shefqet Musarajin, Dhimitër Shuteriqin, Fatmir Gjatën, etj., që i kisha në pension dhe nuk i ndihmoja dot", më ka thënë Agolli gjatë një bisede në shtëpinë e tij, të cilën e kam botuar në gazetën "Sot", në vitin 2005.

Por, ndërsa ndihmonte plot të panjohur, Dritëroi nuk pranoi kurrë që ta ndihmojë Lasgush Poradecin. Vajza e Lasgush Poradecit, Marije Poradeci, shkroi një ditë në "Facebook" se "në momentet kur i ati luftonte me vdekjen, vjen në Pogradec me makinën e tij, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve, Dritëroi Agolli. Sigurisht, shkrimtari komunist nuk erdhi në shtëpinë tonë, qoftë edhe për një vizitë kortezie tek i sëmuri, sipas zakonit shqiptar. Dikush guxoi dhe i tha: Në qoftë se, Lasgushi vdes a duhet ta vendosim trupin e tij në shtëpinë e kulturës, për t'i bërë homazhe dhe t'i japë lamtumirën e fundit i gjithë qyteti atij. Ai u përgjigj, "Jo, ai do varroset si njëri i thjeshtë".

Lasgush Poradeci iku nga kjo botë, në orën 16:00, pasdite, më 12 nëntorin e vitit 1987. Një jetë e vështirë që e kaloi në shtëpinë e tij, me lagështirë, të papërfunduar, në Tiranë, e pjesërisht në shtëpinë e rrënuar të tij, në Pogradec, i sollti edhe sëmundjen, që e çoi drejt vdekjes. "Kostandinë, bijë e



**REPORTAZH/ MES BLETARËVE DHE VRESHTARËVE
TË QUKSIT: SI TI SHMANGEMI VARFËRISË?**

Shpresë në anë të Shkumbinit

Fshatarët fillojnë të bashkojnë forcat dhe mjetet

FATOS BAXHAKU

Evetmja që i gëzohet shiut që bie pa reshtur është rrota e gurtë e një mulliri të vjetër me ujë. Disa mushka të lagura deri në palcë presin me durim të zotët që kanë ardhur të blujnë misër. Zhurma që mbizotëron është vetëm ajo e shiut të rreptë që përplaslet mbi plastmase apo xhama.

Jemi në Qukës. Është e enjte, ditë pazari për krejt fshatrat rreth e rrotull. Këndej është dita më e rëndësishme e javës. Por duket se pazari i sotëm do të shërbejë vetëm sa për të përshëndosur njëri-tjetrin. Mes Shkumbinit dhe xhadesë së re, të gjerë, që ka nisur të ndërtohet mes maleve të Mokrës, plastmaset, ku janë struktur shitës të e pafat, duken si një kamp i madh nomadësh që pret të çmontohet nga çasti në çast. Vetëm njollat e mallrave shumëgjyreshë, që depërtojnë përmes tendave e tezgave të qullura, e thejnë sadopak grinë e fortë që ka mbërthyer prej ditësh krejt luginën e Shkumbinit.

"Eh more çuna - degjojmë një zë pas nesh - për disa shiu bën mirë, për disa bën keq. S'ke ç'i bën. Kështu është ndarë kjo botë". Jemi njohur me Qemal Poçin dhe buzëqeshjen e tij të pasosur. Qemali është kryetari i Shoqatës së Vreshtarëve të Karkavecit, një organizim që fshatarët e këtyre anëve e kanë ngritur me ndihmën e "World Vision-Tirana".

Qemali, tashmë 67-vjeçar, na rrëfen në fillim historinë e tij. Neve na duket sikur ai ka mbledhur nga pak nga të gjitha historitë e fshatarëve të kësaj ane të Shkumbinit. "Kur kam qenë i ri pasioni im më i madh ka qenë muzika", na thotë ai, dhe ne, për pak kohë, i harrojmë fare ato punët e bujqësisë për të cilat kemi ardhur. "Kam qenë shumë i dhënë pas klarinetës. Në të ritit e mi kam bërë disa kurse për vater kulture në Tiranë. Ishte një punë që e kisha me shumë dëshirë. A ka gjë më të bukur se t'i bësh njerëzit të kënaqen?", thotë artisti-vreshtar. "Pastaj - vazhdon ai - erdhën ato kohë që erdhën. Ishin kohë të vështira. Femijët ishin të vegjël. Ne vetë nuk dinim si të orientoheshim me marrëdhëniet e reja. Sa isha i fortë edhe vetë kam punuar çoban në Greqi. As që ia kisha haberin asaj pune. Greqët kishin kope gjigante. Megjithatë, nga halli njeriu çfarë nuk bëka. Pak nga pak, femijët u rritën dhe morën rrugën e kurbetit. Vajzën e kam në Itali, një nga djemtë është në Greqi, i martuar me një greke, djali tjetër në Poloni, i martuar me një polake. Unë kam mbetur me




Qemal Poçi, kryetari i Shoqatës së Vreshtarëve të Karkavecit

plakën këtu. Kështu plotësohet gjeografia ndërkombëtare e familjes sonë".

Tashmë jemi njohur ca më mirë. Ka ardhur koha që të flasim për punë, për atë të vërtetën, për atë

me bel e lopatë. Qemali në fillim kërkon ndjesë. "Ju lutem të na falni sepse ne, që kemi punuar nëpër aktivitetet e vatrave të kulturës, jemi mësuar të flasim ca si gjatë", thotë ai duke mos e hequr nga portreti atë buzëqeshjen e parë. Me pak fjalë, ajo që na rrëfeu Qemali është kjo: Deri para pak vitesh një pjesë e madhe e fshatarëve të Karkavecit, pjesë e Quksit, punonin shumë dhe arrinin pak. Ishin të veçuar prej njëri-tjetrit. Herë u mungonte uji, herë nuk arrinin të gjenin shtylla prej betoni, puna e rëndë prej vetmitarësh nuk arrinte që të qhej e mbarë. Derisa një organizatë bamirëse, "Word Vision", hartoi një projekt shumëvjeçar për t'i ndihmuar. Së pari u bënë bashkë. Së dyti, ndihmat që morën nga "WV", shtylla, tuba uji, freza për të shkriferuar vreshtin, pompa për spërkatje, arka



Ura e Bushtricës pranë Quksit

plastike, madje shpeshherë edhe ndihmën fizike të ndërsjelltë nisën ta ndajnë bashkë. Pak nga pak, vreshtat që dukeshin si njolla të zbehta në peisazhin e kodrave të Quksit, nisën të ktheheshin në plantacione të mbara. Puna tani



Mokër, 1940



Shqipëria e Mesme, 1940

HISTORI NGA QUKSI Lufta e Madhe TETOR 1917, MAROKENË BUZË SHKUMBINIT

"... Atë që nuk e jepte harta - shkruante koloneli Guespereau duke kujtuar atë betejë - është se Shkumbini rrjedh në një thellësi shkëmbore prej 300-400 metrash, me shkëmbinj të pakalueshëm, ku përmes tyre mund të kalohej në këmbë në vështirësi, duke u kapur pas çdo peme. Andej kalonte regjimenti i spahive në mëngjesin e datës 19 tetor...". E pikërisht gjatë atij kalimi, ata qëllonin nga ushtria austriake e vendosur në majë të krahut tjetër, e mbrojtur nga transhe të rrethuara me gurë dhe me tela me gjemba, të armatosur gjer në dhembë... Gjatë dy orëve francezët qëllonin nga artileria armike, por ndërkohë, me sëpata, ata çajnë shtigjet dhe mitralierët francezë arrijnë të zënë pozicione nga ku mund të qëllonin në drejtim të fortifikimeve. Dhe, në këtë shkëmbim zjarri, vritet i pari mitralieri Charles Berigne. Ndërkohë, komandanti Ving arrin t'u afrohet fortifikimeve armike në distancën e 900 metrave, i pasuar nga zëvendëslejnantët Permet dhe Pierre. Gjatë asaj dite, drejt fortifikimit austriak, francezët lënë 5 të vrarë dhe 11 të plagosur. Midis tyre ranë dhe Brahim ben Rahal, Mohamed ben Bellaoui, Mohamed ben Ahmet, Regragui ben Smain. Por të tjera luftime zhvillonin ndërkohë në krejt atë zonë. Në Stravaj plagosej Henri Wuilibert me katër plumba në trup... Në një letër që i dërgonte më pas nënës së tij, ai i shkruante: "Po nënë, regjimenti ynë e ruajt flamurin, por e pagoi shtrenjtë, pasi në betejë ranë shumë nga shokët tanë. U nisa në sulm me 25 shokë, por u kthyem vetëm 6. Të tjerët mbetën në luftë..."

(Luan Rama, *Bonjour d'Albanie, Les Livres Rama, 2014*).

1942-1943 NË FILLIM TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

"... Në fund të vitit 1942, fashistët italianë organizojnë një operacion spastrimi në fshatin Karkavaec, pasi kishin informacione se në këtë fshat ka armë dhe qarkullojnë njerëz të dyshimtë. Italianët grumbullojnë 40 pushkë dhe arrestojnë Shamet Muratin, Filo Blloshmin, Fejzulla Gollin, Ibrahim Blloshmin dhe Isuf Facen... Më 13 shkurt 1943, aktivistët antifashistë në Bërzesh të bllokujnë taksidarin Demir Koçi nga Dumreja të mos transportojë bereqetin e grumbulluar prej tij për në Elbasan. Njëkohësisht bëhet edhe shpërndarja e tij popullit. Në periudhën prill-maj 1943 në zonën Karkavec-Bërzesh të kronika historike regjistrojnë disa aksione të kryera nga luftëtarë të çetave të Xhevat Blloshmit e Sali Radakut. Këta, me 12-13 burra të armatosur shpartallojnë postën e xhandarmërisë në Qukës. Në këtë aksion sigurohem mjaft material lufte e veshmbathje. Në fillim të majit 1943 Xhevat Blloshmi me disa partizanë sulmojnë dhe dëgjin barangat dhe kapononet italiane të minierës së kromit në Pishkash. Këto aksione janë shkëndijat e para të organizimit të luftës së armatosur... Në 16 korrik 1943 vriten në Pojskë Reshit Çolaku, Ptoleme Xhuvani dhe të tjerët. Dhimitër Shuteriqi kujton: "Gjatë tërheqjes, avionët kanë mitraluar të gjithë zonën duke shkatëruar edhe viktimat. Atë natë ishim të detyruar të qëndronim në Golik, në një familje. Fshatari atë natë bëri darkën e Reshitit të vrarë, sikur ta kishte njeri të familjes. Theri mish e ngriti doli njerën pas tjetrës për 'shpirtndriturin Reshit', për trimërinë e partizanëve dhe për ngordhjen e fashizmit..."

(Shaban Gjura, *Librazhdi dhe LANÇL, Tiranë 2008*).



“ Mes Shkumbinit dhe xhadesë së re, të gjerë, që ka nisur të ndërtohet mes maleve të Mokrës, plastmaset, ku janë strukur shitësit e pafat, duken si një kamp i madh nomadësh që pret të çmontohet nga çasti në çast. Vetëm njollat e mallrave shumëngjyrëshe, që depërtojnë përmes tendave e tezgave të qullura, e thyejnë sadopak grinë e fortë që ka mbërthyer prej ditësh krejt luginën e Shkumbinit.

ishte se çfarë do të bënin me prodhimin e rritur në mënyrë të befte. Edhe një herë u erdhën në ndihmë ekspertët e "WV". Qemali dhe të tjerët tani duhej të merrnin laps e letër dhe të ktheheshin në nxënës në moshë të rritur. Kishte ardhur koha e trajnimeve: Si të shesim e si të blejmë? Si të ambalazhojmë? Si të sillemi me klientët?

Ndërsa Qemali vazhdon të përsërisë se sa mirë është kur njeriu nuk e ndjen veten të vetmuar, kemi mbërritur në një oborr të stërmbyshur me koshere bletësh. Këtu do të hasim në një rast thuajse të rrallë. Floreta Sula është nga të paktat bletërritëse femër - që nuk ndihet nga asnjë mashkull i familjes - në krejt Shqipërinë".

Në murin e kuzhinës së Floretës një portret i madh, i varur në mur na shikon si me habi. Të paktën neve na duket kështu. "Kjo është fotografia e babait tim të ndjerë - na thotë bletërritësjja - prej tij e kam marrë të gjithë pasionin. Ai ishte një bletërritës i njohur në krejt krahinën. Unë i shkoja pas që e vogël. Pak nga pak arrita që ai të kishte besim vetëm tek unë. Kështu e mora këtë profesion që në moshë fare të re. Kur babai na la, ishte krejt normale që ta vazhdoja këtë profesion. Nuk hezitova për asnjë moment dhe vazhdova punën e tij. Nuk ka qenë e lehtë.



Hekurudha e braktisur mbi urën e Bushtricës

Vetë bletaria është një profesion i vështirë në vetvete, por edhe mentalitetet e këtushme nuk janë nga ato që e pranojnë lehtë një femër të vetme që "u merr" një punë që ka qenë vetëm privilegj i meshkujve. Megjithatë, me punë çdo gjë kalohet. Për mua të merrem me bletët nuk është thjesht një punë me të cilën mbaj shtëpinë, por shumë më tepër një pasion i madh. Unë nuk kam njohur gjë më perfekte se sa një koshere bletësh. Sa mirë do të ishte sikur edhe shoqëria njerëzore të ishte ashtu...".

Unë si për analizat e bletëve, që për ne është shumë e rëndësishme", thotë Floreta. Vetë ajo është anëtare e Këshillit të Biznesit, një organizim vullnetar vendas, që përbëhet nga vreshtarë e bletërritës. Ndihma, koordinimi i punëve mes tyre, marrëdhëniet me të tretët, këmbimi i eksperiencave, farërave, fidanëve, këto janë punët e këshillit. Ne na duket se sukcesi i tyre më i madh ka qenë fitorja kundër vetmisë, sëmundjes së kohës.



Shqipëria e Mesme, pazar

Ka nisur emisioni i lajmeve në TV dhe, sikurse ndodh zakonisht në të tilla raste, njerëzit heshtin duke i lënë vendin spikerit. Sikur ta kishim bërë me porosi, nga ekrani vjen një lajm që lidhet fort me miqtë tanë: sipas një studimi të BE-së, Shqipëria është ku e ku më poshtë se sa fqinjët e saj ballkanikë në subvencionet shtetërore për bujqësinë. Qemali nuk flet, tashmë e ka kaluar "minutazhin" e tij. "Sikur të mos ishte "WV" do të ishim njësoj si ata fshatarët e vetmuar, që mezi nxjerrin bukën e gojës. Falë tyre kam marrë ndihmë për kosheret e gjërat të tjera që më duheshin, por edhe tra-

SHQIPËRIA E BRISHTË NJË ZVICERANE NË KËTO ANË, 1922

"... Kalojmë me kalë barrierën e maleve që rrethojnë liqenin, duke zbritur shpatin tjetër, ndjekim pllajën që sundon sipërfaqe të gjera tokash të egra e të mbuluara me shqopishte. Jemi ndalur buzë një përroi. Dhe fshatarët që ndodhen atypari nxitojnë menjëherë të na sjellin vezë dhe rrush, që na i ofrojnë duke buzëqeshur, duke na kërkuar ndjesë me dorë në zemër se nuk u ndodheshin gjëra të tjera më të mira... Në një shtëpi feudale gjysmë të mbyllur dhe gjysmë kështjellë, marrim pjesë para darke në ceremoninë e "mezësë". Të gjithë burrat, prindërit, kushërinjët janë mbledhur aty. Të ulur mbi minderet e ulëta, ata kanë në mes një pjatcacë me mishra të ftohtë, tru, mëlçi të gatuar në formë shishqebapi, ushqime të çuditshme dhe delikate, të cilat kapen me një copëz kunje me majë. I zoti i shtëpisë mbush gotat e rakisë, pije alkoolike e bërë me fruta. Dhe sa herë mbushen gotat, njëri ose tjetri syresh, duke përshëndetur me dorën mbi zemër, ngre dollinë për shëndetin e të huajve. Gotat e vogla nuk rreshtin së mbushuri. Toni vazhdon të jetë serioz. Askush nuk e ngre zërin, fjalët shkëmbehen të ngadalta, thuajse me zë të ulët. Fytyrat e ashpra me mustaqe deri poshtë, ndriçojnë dhe shtrihen me një buzëqeshje. Por nuk ka asnjë shpërthim hareje të zhurmshme...".

(Noelle Roger, 'Nëpër udhët e Shqipërisë', Pegi, Tiranë 2008).

VERË 1925 DY ANGLEZË NË HANIN E QUKSIT

"... Hello, përhëndeti Xhoi, duke hyrë në hanin e varfër në Qukës mbas një dite udhëtimi me kalë nga Elbasani. Ajo që e vetmja shtëpi diku në mes të rrugës deri në Pogradec.

- Kush është hanxhiu?
- Unë - tha një djalë i vogël të dy dymbëdhjetat, - unë jam hanxhiu.

- Çfarë ka për të ngrënë, - tha ajo - se jemi shumë të uritur.
- Çfarë dëshiron të porosisë zotëria juaj, - pyeti hanxhiu.
- Vezë?
- Sigurisht.
- Mish?
- Ka qingj të pjekur.
- Qumësht?
- Sa të doni.
- Kafë?
- Pa dyshim.

Kështu që ne porositëm një darkë të kënaqshme dhe në pritje të saj u ngjitëm në dhomë. Hani ishte një sajese kasolleje dykatëshe. Dhomat e gjumit ishin krejtësisht të nxira nga tymi dhe nuk kishin shtretër. Kishte vetëm hasra kashte të shtruara në dyshe. Hani ndodhej në një vend të ngritur dhe pranë tij pronari kishte ndërtuar një shtëpi të vrazhdë verimi në mes të një grumbulli shkëmbinjsh. Këtu pra qëndruam duke pritur rreth një gjysmë ore derisa ankesat e stomakëve tanë filluan të bëheshin më këmbëngulëse dhe ne u kthëm në han të shihnim se si po përgatitej darka...".

(Jan&Cora J. Gordon, 'Dy breðrarakë në Shqipëri', Durrës 2014).

Shiu ka pushuar, fëmijët e shkollës së Karkavecit e kanë mbaruar mësimin. Duke vrapuar për në shtëpi përmes rrugicave të fshatit të rrethuara nga vreshtat dhe frutat, ata ngjasojnë me një tufë të hareshme kecash. "Desh Zoti, këta

nuk do t'i kalojnë ato kohët tona...", Qemali ende nuk e ka hequr atë buzëqeshjen e mbarë.

(Shkëputur nga Fatmira Pjetri. Ky shkrim u ndihmua nga 'Word Vision-Tirana').

LIBRAZHD/ PANAIRI "FESTA E MJALTIT"



FOTOLAJM

Panairi "Festa e Mjaltit" u organizua në Librazhd nga bashkia dhe "WV". Në të morën pjesë mbi 100 biznese lokale. Librazhdi është një nga zonat më të njohura për mjaltin. Zyrtarisht këtu ka 465 bletërritës me 6755 koshere. Veçanërisht të njohur janë mjalti i gështenjës dhe akacies. Në një sipërfaqe të përgjithshme prej 100 hektarësh, 80 e zënë pjyjet dhe kullofat. Në këtë krahinë ndodhet edhe Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, shumë i pasur në lloje të ndryshme pemësh dhe shkurresh.

STUDIMI

Pëllumb Xhufi:

Elita të vjetra e të reja në luftën për pavarësi*



Si e luftuan Ismail Qemalin, "oxhaqet" e mëdha shqiptare, bejlerët dhe kushërinjtë e tij

Nga Prof. Pëllumb Xhufi

Studimet mbi mendimin politik e kulturor të Rilindjes Kombëtare kanë konvergjuar, tashmë, në përcaktimin e karakterit të saj si një lëvizje sa nacionale, aq edhe demokratike". Ngjarjet që kulmuan me shpalljen e Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, u zhvilluan në kushtet kur në vetë gjirin e shoqërisë shqiptare kishin ndodhur zhvendosje të mëdha dhe kur në vend të elitës së vjetër feudale e turkoshake, të komprometuar rëndë me regjimin osman, një elitë e re, e përfaqësuar nga intelektualë me ide liberale e socialdemokrate, kishin dalë në skenën e historisë dhe pretendonte ta udhëhiqte popullin shqiptar në luftërë për liri e për shtet kombëtar. Të frymëzuar nga idetë e Iluminizimit francez e të Risorgimentos italiane, ideologjia e veprimtarë të lëvizjes kombëtare shqiptare e shihnin ndarjen nga "regjimi i vjetër" si një domosdoshmëri historike, që nëpërmjet një revolucioni nacional e social, bashkë me sundimin osman, do të flakete tej edhe gjithëpushtetin e "oxhaqeve" shqiptare, klasat e vjetra të bejlerëve, pashallarëve, krerëve fisnorë e klerikëve të lartë, bashkëpunëtorë të sunduesit të huaj... Ato janë bërë të pasura e të pushtetshme duke përdorur mjetet, më së shumti dhunën e pushtuesve ndaj popullit të vet".

ANALIZA HISTORIKE

Një analizë të grupeve shoqërore dhe të sjelljes së tyre kundër çështjes kombëtare në Shqipëri në prag pavarësisë, e bën në mënyrë mjeshtrërore në raportin e tij të 5 shkurtit 1912, konsulli austro-hungarez në Janinë, Belinski. Nga njëra anë Belinski veçon përfaqësuesit e aristokracisë së bejlerëve, të pashallarëve dhe të bajraktarëve, të cilët sipas tij ishin njësuar me klasën sunduese osmane. Këtu Belinski përfshin personazhe si Ferid Pashë Vlorën, Myfid Bej Libohovën, Esad Pashë Toptanin e të tjerë. Në krahasim tjetër,

sipas tij, qëndronin patriotët e vërtetë shqiptarë, të cilët, sipas Bilinski, i përkisnin shtresës së mesme të mësuesve të shkollave shqipe, botuesve të gazetave, sekretarëve të klubeve, nëpunësve dhe oficerëve shqiptarë. Ishin këta që kishin bërë Rilindjen Kombëtare, që kishin përhapur arsimin në gjuhën shqipe, që kishin forcur ndërgjegjen kombëtare, që kishin ndërgjegjësuar qarqet evropiane për ekzistencën e kombit e të çështjes kombëtare shqiptare dhe që kishin përgatitur e drejtuar betejat e armatosura për liri e pavarësi të çetave të armatosura patriotike. Ishte kjo, ajo "klasë e mesme" e stigmatizuar vazhdimisht në "Kujtimet" e Eqrem Bej Vlorës edhe shumë vite pas krijimit të shtetit shqiptar. Pasi bën këtë dikotomi klasore, Bilinski nuk harron të vëjë në dukje se disa nga përfaqësuesit e parisë feudale, duke e para ndjerë se me rënien e Perandorisë do humbin pushtetin, prestigjin dhe privilegjet e tyre të vjetra, iu bashkuan në castin e fundit lëvizjes kombëtare. Këta nuk shihnin mundësi tjetër, veç asaj të përfshirjes në lëvizjen për pavarësi, për të mundur të luain edhe më tej një rol udhëheqës në jetën politike të vendit. "Megjithatë", e mbyll analizën e tij konsulli Bilinski, "Lëvizja e çetave toste vitin e kaluar u

organizua krejtësisht prej shtresës së mesme të intelektualëve patriotë. Bejlerët nuk morën pjesë fare në këtë aksion... Ndonjë prej këtyre bejlerëve, si Mehmet Ali Pasha i Delvinës, deputeti Mufid Bej Libohova e ndonjë tjetër, u detyruan në ndonjë rast t'u jepnin çetave ndihma në të holla, por këtë e bënë nën presionin e elementëve radikalë të lëvizjes së armatosur; të cilët kërcënonin se do ndërmerrenin akte terroriste kundër tyre në rast se nuk bashkëpunonin".

Megjithatë, duhet thënë se jo në gjithçka këto vlerësime të Bilinski përputheshin me ato të ndonjë veprimtari shqiptar. Kështu, mbi bazën e një perspektive më shumë historike, sesa klasore, Nikoll Ivanaj i konsideronte si "patriotë të mëdhenj" deri edhe Ali Pashë Tepelenën e Mustafa Pashë Bushatliun e Shkodrës, "të cilët luftuan kundër Sulltanit për pavarësinë e Shqipërisë". Fan Noli i bashkoi, gjithashtu, këtë vlerësimi historik ndaj figurave të tilla. Madje, nisur nga vlerësimi se populli i paditur nuk ishte i prirur t'u vente pas intelektualëve patriotë, të cilëve u mungonte "historia", emri dhe prestigji familjar, në vitin 1906 ai shprehte bindjen se lëvizjes kombëtare do t'i vlenë më shumë të tërhiqte në gjirin e saj krerët e oxhaqeve e të bajraqeve të mëdha të

Shqipërisë, ide të cilën ai vetë më vonë e braktisi në mënyrën më radikale.


Siç treguan faktet, në përgjithësi, elita e vjetër e bejlerëve, pashallarëve, krerëve e bajraktarëve, i qëndroi deri në fund besnikë Perandorisë Osmane, dhe akoma më keq, filloi të flirtojë me monarkitë fqinje, pikërisht me ato që rrezikonin më së shumti integritetin territorial të Shqipërisë. I bindur për këtë rol antikombëtar të bejlerëve turkoshakë shqiptarë, më 12 shtator 1901, nga faqet e gazetës "Albania", patrioti Dervish Hima i akuzonte ata se kishin tradhatur çështjen shqiptare "për medaljet prej teneqeje që ua var në gjoks Sulltanit". Dhe u kujtonte se në Evropë "mbretërit, princat e fisnikët kishin kaluar në shpatën e drejtësisë së popullit", dhe se "ata që ju keni keqtrajtuar e poshtëruar, nesër do nderohen... ndërsa fëmijët e gratë tuaja do të hiqen zvarrë nëpër rrugë për shkakun tuaj".

Figura më emblematike e parisë së vjetër shqiptare në periudhën e kapërcimit nga shthurja e Peran-

1900

KUSHËRINJTË

Kur në vitin 1900 I. Qemali arratisëj nga Tripoli për në Evropë për të organizuar lëvizjen çlirimtare, kushërinjtë e tij, Ferid Pasha, nxitoi t'i sqaronte Sulltanit luajalitetin e palëkundur të familjes Vlorë ndaj Portës së Lartë: "Unë dhe vëllezërit e mi, Neshat Pasha e Syrja Beu, nuk kemi asnjë lidhje me një të poshtë, bukëshkalë e aventurier, që jeton në botën e errët të ateizmit: ne do i shërbejmë me besnikëri Padishahut, ashtu siç i kemi shërbyer deri tani".



Ismail Qemali (Vlora)

dorisë në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, është pa dyshim Esad Pashë Toptani. Të shumta janë vlerësimet që i janë bërë atij nga njerëz që e kanë njohur, por që të gjitha janë ekstremisht negative: Esadi ishte njeriu "që nuk dinte asnjë gjuhë të huaj, por që u dinte vlerën të gjitha monedhave të Evropës", ishte njeriu i cili "ishte gati të shiste të gjithë vendin, që të mund të sundonte qoftë edhe në një katund të vetëm të tij". Nuk ia falli Ismail Qemalit, kryeministër i qeverisë së përkohshme, faktin që ai u kishte akorduar një kredi malësorëve të Mbishkodrës, të rrënuar e të përzhitur nga luftërat e gjata me osmanët. Sipas Esadit, malësorët nuk e meritonin këtë ndihmë, pasi ishin "kaurë" dhe kishin luftuar kundër "myslimanëve" të tij. Marrëveshjet e tij të fshehta me E. Venizellosin e Greqisë, më "kryeministër" e qeverisë së "Epirit autonom" dhe me N. Pashiqin e Serbinë, në gusht-shtator 1914, e bënë atë prototipin e politikanit shqiptar, që për të ruajtur pushtetin, nuk heziton të nxjerrë në ankand interesat dhe territoret e atdheut të tij. Jo më kot, serbët e kishin projektuar atë si udhëheqës in një minishteti shqiptar, satelit të Serbisë.

Nuk ka dyshim, se përfaqësuesi më i lartë i grupimit të intelektualëve patriotë ishte Ismail Qemali. Një personalitet që përmbledhte në shkallën sipërore të gjitha tiparet e një lideri të padiskutuar. U nda shpejt nga klasa e tij e bejlerëve, dhe u konvertua në një sipërmarrës kapitalist, kur nga pronat e familjes zgjodhi të administrojë minierën e bitumit të Selenicës, të cilën më vonë e shiti. Në vitin 1900, konsulli A-H. Petroviç e përshkruante Ismail Qemalin, si një person të ditur e inteligjent, por pa pasuri. Ashtu si vëllezërit Frashëri, Faik Konica, Said Bej Toptani, Fehmi Zavalani e Shahin Kolonja, ai jetoi me forcën e mendjes, dhe jo merentë feudale, si pinjollët e tjerë të familjes Vlorë. Iu kushtua edukimit e nëpunësisë. Si intelektual me ide liberale, u përfshi në procesin re-



“Elita e vjetër e bejlerëve, pashallarëve, krerëve e bajraktarëve, i qëndroi deri në fund besnike Perandorisë Osmane, dhe akoma më keq, filloi të flirtojë me monarkinë fqinje”

formues të Perandorisë Osmane, i bindur se kështu, në atë *Commonwealth* popujsh, shqiptarët do të gjenin hapësirë për të afirmuar kombësinë e tyre të mohuar. Ishte formuar në frymën e “Deklaratës së të Drejtave të Njeriut” të shpalur nga Revolucionari francez, por kjo nuk e ndalonte të denonconte pikërisht Francën, vendin e lirive, e cila shtypte egërsisht lirinë dhe popullsitë myslimane në kolonitë e veta. Kur e pa se pushteti despotik i sulltanëve nuk u la asnjë shans reformave decentralizuese, preu çdo marrëdhënie me Portën e Lartë, u arratis dhe vendosi t’i përkush-tohej kryekëput çështjes shqiptare. Në thirrjen që Ismail Qemali u drejtoi shqiptarëve, më 15 tetor 1900, thoshte: “Kuptova se nuk ishte punë të vazhdoja të përiqesha të shpëtoj Perandorinë Turke...E ndjeva, se në rrokullimën e përgjithshëm që do përfshinte Perandorinë, Shqipëria e do copëtohej e para”. Ndërkohë i kishte përjetuar të gjitha emocionet kulturore të Rilindjes Kombëtare: ishte përfshirë në debatet për alfabetin e Stambollit dhe kishte mbrojtur me ngulm gërmat latine, kishte ndërhyrë fort për të mundësuar botimin e fjalorit të Kristoforidhit, kishte tentuar të shpjegonte me gjuhën shqipe mbishkrimet e zbuluara në Kretë nga Artur Evans dhe kishte shkruar ai vetë orakullin e Dodonës, tempullin e Pellazgëve, të cilët ai si shumë rilindës të tjerë i konsideronte paraardhësit e Shqiptarëve.

OXHAQET

Nuk i besonte “oxhaqeve” të mëdha shqiptare, të cilët i qëndruan besnik Perandorisë deri në ditët e fundit të saj. Bejlerët nuk iu përgjigjën thirrjes së tij për t’u përfshirë në kryengritjen e vitit 1911. Nuk iu përgjigjën as kur në 10 shkurt 1913 I. Qemali i bëri thirrje “parisë” së Jugut të mobilizonte njerëz për t’i shkuar në ndihmë Janinës së rrethuar nga ushtritë greke. Por edhe kësaj radhe pashallarët dhe bejlerët e Jugut iu përkushtuan ruajtjes së pronave e të privilegjeve të tyre, qoftë edhe duke rënë në ujdi pikërisht me qar-

qet greke. Nga një pozicion krejt i ndryshëm, në fund të jetës së tij, pinjollit i lavdishëm i Vlorajve, do ta shprehte me këto fjalë idealin e tij, njëherësh kombëtar e demokratik: “*Lipset të fitojmë me çka do mënyrë Kosovën, Manastirin, Janinën e gjithë Çamërinë...Unë shpresën nuk e kam tek bejlerët dhe arkondët që kërkojnë të fitojnë titull e princë...Shpresa ime është të të zotët e opingarët që janë zotët e vërtetë të Shqipërisë*”.

Krejt ndryshe nga Ismail Qemali u sollën kushërinjtë e tij nga familja Vlorë, edhe më tej përfaqësues nga më konservatorët e parisë feudale. Kur në vitin 1900 I. Qemali arratisë nga Tripoli për në Evropë për të organizuar lëvizjen çlirimtare, kushëririn i tij, Ferid Pasha, nxiti t’i sqaronte Sulltanit luajalitetin e palëkundur të familjes Vlorë ndaj Portës së Lartë: “Unë dhe vëllezërit e mij, Neshat Pasha e Syrja Beu, nuk kemi asnjë lidhje me një të poshtër, bukëshkalë e aventurier, që jeton në botën e errët të ateizmit: ne do i shërbejmë me besnikëri Padishahut, ashtu siç i kemi shërbyer deri tani”, Ferid Pasha, Syrja Beu dhe deri Eqrem Bej Vlorë e ndjenin veten aq shumë të lidhur me Perandorinë Osmane, sa që të pretendonin se edhe origjinën e kishin nga Konia e An-

Nuk i besonte “oxhaqeve” të mëdha shqiptare, të cilët i qëndruan besnik Perandorisë deri në ditët e fundit të saj. Bejlerët nuk iu përgjigjën thirrjes së tij për t’u përfshirë në kryengritjen e vitit 1911.

në shkurt 1911 organizoi në lagjen Taksim të Stambollit një mbledhje me deputetë shqiptarë të parlamentit osman.

I bindur për kolapsin e shpejtë të Perandorisë dhe për rrezikun eminent të pansllavizmit, I. Qemali punoi për të ndërtuar aleanca parimore me vendet fqinje. Në këtë vështrim u mundua të ndërtojë një aleancë të qëndrueshme me grekët, popull po aq i vjetër e me interesa të ngjashme me shqiptarët. Por nuk bëri pazar me ta, nuk shiti kufij e interesa kombëtare. Është folur për bisedime e marrëveshje të tij të fshehtë me Kryeministrin Theotoki, në Athinë, në shkurt 1907. Por thelbi i qëndrimeve të I. Qemalit gjatë atij takimi, zbulohet nga deklarata që ai nënshkroi ndonjë ditë më vonë pas takimit me kryetarin e shoqërisë “Helenismos”, Kazazis. Në pikën 2 të asaj deklaratë flitet për një “kufizim të ambicieve kombëtare të të dy popujve brenda kufijve historikë e gjeografikë, duke marrë në konsideratë shumicën e banorëve që flasin nërën nga të dy gjuhët”. Me këmbënguljen e Ismail Qemalit, pala greke angazhohej të punonte “për futjen e gjuhës shqipe në shkollat greke dhe, gjithashtu, për futjen e shqipes në kishë”. Pa e përfillur presionin e vazhdueshme të Athinës mbi patriotët shqiptarë, për t’i kufizuar lëvizjet kryengritëse vetëm në Shqipëri dhe Veriut, Ismail Qemali bëri gjithçka për të ndezur flakët e tyre edhe në Jug.

Pas shpalljes së Pavarësisë, I. Qemali e konsideroi të rëndësishme për ruajtjen e integritetit të shtetit shqiptar, mbajtjen e një marrëdhënieje të arsyeshme me Turqinë. Dhe pas shpërthimit të Luftës II Ballkanike më 1913, ai ishte i pari që e kuptoi rëndësinë e një marrëdhënieje, gjithashtu, të ngushtë me Bullgarinë. Më 1913, si Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve në Londër përcaktimin e një vije kufitare të drejtë me fqinjët, që të përfshinte, veç të tjerash, Pejë, Mitrovicën, Prishtinën, Shkupin e mundësisht Manastirin deri në Mecovë e Prevezë”. Nuk u pajtua me copëtimin iu bë trupit të Shqipërisë në atë Konferencë dhe deri në fund të jetës nuk hoqi dorë nga ideja e një Shqipërie të bashkuar në kufijtë e saj etnikë. Në një letër të tij të 10

Ferid Pasha, nxiti t’i sqaronte Sulltanit luajalitetin e palëkundur të familjes Vlorë ndaj Portës së Lartë: “Unë dhe vëllezërit e mij, Neshat Pasha e Syrja Beu, nuk kemi asnjë lidhje me një të poshtër, bukëshkalë e aventurier, që jeton në botën e errët të ateizmit: ne do i shërbejmë me besnikëri Padishahut

marsit 1918, shkruante: “Lipset t’i dëftojmë botës së qytetëruar cili është kombi shqiptar, cilat janë të drejtat dhe dëshirat e këtij kombi dhe qysh pa iu shtuar Shqipërisë nga ana e Veriut Kosova e nga ana e Jugës Çamëria, nuk mund të shtrohet qetësia në sinisin e Ballkanit”.

Nuk mbajti qëndrime servile ndaj të huajve, dhe ju kundërvu atyre, kur gjykoj se ata vepronin kundër interesave shqiptare. E çmonte rolin e pazëvendësueshëm që Austro-Hungaria luante në avancimin e interesave kombëtare shqiptare. Por iu kundërvu politikës së saj të *status-quoës*. Nuk ia fall Austro-Hungarisë ndërhyrjen e saj për ta shuar kryengritjen e Mbishkodrës, duke përdorur për këtë qëllim edhe klerin katolik. Në prononcimin e tij të hidhur në gazetën vjeneze “Die Zeit”, të datës 31 korrik 1911, Ismail Qemali shprehej: “Gabimet politike janë të pafalshme, por një qëndrim politik që *kushon jetën e një populli të tërë është në kundërshtim me çdo moral politik*”. Së fundi, vlen të evidentohet edhe një çështje tjetër, për të cilën I. Qemali pati mosmarrëveshje me politikën austro-hungareze, dhe që dëshmon vizionin dhe intuitën e tij të jashtëzakonshme politike. Fjala është për projektin e hekurudhës së Sanxhakut, që Austro-Hungaria vendosi të ndërtojë pas aneksimit të Bosnjë-Hercegovinës më 1908, e cila hekurudhë do zgjatej deri në Mitrovicë të Kosovës e prej andej në Durres. Sipas konsullit Kraus, që e takoi dhe bisedoi me I. Qemalin për këtë çështje, udhëheqësi shqiptar e kundërshtonte realizimin e këtij projekti, pasi, sipas tij, kjo hekurudhë në të ardhmen do mund të bëhej bartëse e ekspansionit sllav në trevat shqiptare. Jo më kot, Ismail Qemali e quante atë hekurudhë “hekurudhë sllave”. Njeriu, i cili e kishte parashikuar kolapsin e Perandorisë Osmane qysh në vitin 1900, e dinte mirë se një ditë do të shpërbehej edhe Perandoria Austro-Hungareze. Si për të vërtetuar dyshimet e tij, në 14 shtator 1914, përfaqësuesit e qeverisë serbe nënkshkruan në Nish një marrëveshje me një Pasha shqiptar, pika 11 e së cilës parashikonte ndërtimin e “hekurudhës Adriatike”, e cila do të dilte në Durres. Në fund të vitit 1915 e njëjta marrëveshje u ripërtëri, duke sanksionuar, veç ndërimit të hekurudhës, edhe një bashkim i vërtetë mes Serbisë e Shqipërisë, me unifikimin e ushtrisë, doganave, diplomacisë, financave e tregtisë (pika 8). Kësaj radhe, për palën serbe nënkshkroi Ljuba Jovanović, i dërguar special i kryeministrin Pashiç. Ndërsa për palën shqiptare nënkshkroi i njëjti person: Esad Pashë Toptani. Kështu, ky “pasha” injorant e i paskrupullt, që nënkshkruante për çdo vit nga një marrëveshje antikomëtare me armiqët e Shqipërisë, tërhoqi mbi vete urrejtjen mbarëshqiptare, që çoi në atentatin e kryer ndaj tij nga dora e patriotit revolucionar Avni Rustemi, më vonë deputet i Kosovës në parlamentin shqiptar. Dhe si për të vulturur një jetë të shpenzuar në favor të interesave të huaja, serbët e vendosën trupin e Esad Pashë Toptanit në varrezat serbe, në Paris.

(Titulli është i autorit, të gjitha detajet e nëntitujt janë të redaksisë)

Opinion i Ditës

Lotët e Gertës, tallja e Ramës dhe mjerimi i ulur këmbëkryq kudo në fshat e qytet

Nga Belind Këlliçi*

(Vijon nga faqja e parë)

... Janë lot dhe mbetje dhe trishtimi për realitetin që ndjen së pari ajo, e pas saj edhe të tjerët.

Gerta ishte një e panjohur për një pjesë të mirë të qytetarëve. Gerta u bë e njohur në kronikat dhe reportazhet televizive si vajza mirditore që ka studiuar për shkencën politike në universitetin prestigjioz të "La Sapienza"-s në Romë, e specializuar për marrëdhënie ndërkombëtare, e cila më pas u kthye, por dyert e bashkisë së qytetit të saj Mirditës, i gjeti të mbyllura për një punë dhe hap një fermë me dhi.

Ndoshta lotët e Gertës në parlament, lidhen më së shumti me faktin që një vajzë si ajo, e mirasimuar dhe e edukuar, nuk gjen dot hapësirë të ulet në ato karrige të pushtuara nga gjithfarë kriminelësh, mashtruesish, hajdutësh e analfabetësh.

Gerta u ankua për rrugën e fshatit, dhe ka të drejtë, sepse në katër vite nuk u shtrua asnjë metër rrugë, as në qytet dhe as fshat. Mjafton të shohësh aksin Tiranë-Elbasan, që vështirë se do të mbyllet edhe në këtë mandat.

Nuk i paragjykoj aspak lotët e saj, në veçanti për mungesën absurde të ujit e rrugës, sepse ndarja e re territoriale hoqi gjithë vëmendjen nga fshati dhe e zhyti atë në mjerim.

Infrastruktura e arave të mbjella me kanabis dhe sigurisë e kriminit ishin dhe mbeten prioritetet për Edi Ramën.

Teksa Gerta fliste, m'u kujtua Dibra. Mjerimi që pamë në fshatrat e Dibrës më sjell trishtim sa herë e kujtoj. Katër vjet të harruar, të braktisur. Ndarja e re territoriale dhe mungesa e investimeve ua kishte vështirësuar jetën. Nuk kishin më as shërbimet më elementare dhe për ta, fatkeqësisht, rruga ishte kthyer në luks. "Jemi rikthyer në mesjetë" më pati thënë



një grua e re dibrane, e cila vuanë përditë gjendjen e krijuar. Por fatkeqësisht, ajo dhe shumë të tjerë e harruan këtë mjerim ditën e votimit dhe preferuan 2.000 lekë sot, për të shtyrë ditën në këmbim të votës, dhe harruan se pas asaj dite, mjerimi aty do ishte si më parë e do të thellohej edhe më tej. Kjo ndodhi edhe më 25 qershor e do të ndodhë gjithmonë derisa qytetarët ta kuptojnë rëndësinë e votës. Ato pak para apo një thes me miell për votën janë zgjidhja e një dite, por mjerimi aty do të jetë nesër pasnesër dhe çdo ditë. Sepse kur të blejnë votën, nuk kanë më asnjë detyrim dhe vijnë rrugën të bindur se do t'ju blejnë përsëri me paratë e grumbulluara nga krimi e korrupsioni. Lotët e Gertës janë simbol i lotëve të shumë e shumë grave dhe

burra gjatë qeverisjes së Edi Ramës.

Lotët e Gertës janë të njëjtë me lotët e grave dhe fëmijëve të lagjes "Fushë Mbret" të Elbasanit, kur policia në mes të natës, si bandite, ushtri terror mbi ta, e natyrisht jo për krimin që sot ka marrë nën kontroll të plotë qytetin, por për 3.000 lekë energji të papaguar.

Lotët e Gertës janë po lotët e atij kryefamiljarit në Lushnjë, që dy ditë pasi INUK-u i kishte prishur shtëpinë me leje, i tha se mund ta rindëronte, pa mbajtur asnjë përgjegjësi se kishte nxjerrë në mes të katër rrugëve fëmijë, gra e burra, njerëz me dinjitet!

Lotët e Gertës janë dhe lotët e fëmijëve të Arif Dodës, i cili i mori jetën vetes se nuk paguante dot energjinë elektrike.

Po, lotët e Gertës janë lotët e qindra kryefamiljarëve të papunë që nuk sigurojnë dot bukën për fëmijët e tyre, librat e shkollës, ujin dhe dritat apo, më keq, dergjen në kampet e refugjatëve bashkë me sirianët nëpër Europë.

Gerta, edhe unë si ti kam studiuar jashtë, në SHBA, dhe ashtu si ti edhe unë mendoj se qeverisja për qytetarët është krejt e ndryshme nga kjo që na udhëheq sot.

Prandaj të kërkoj të mos i fshish lotët e aq më pak të lejosh pushtetin të keqpërdorë lotët e tu, por të gesh forcën t'u bashkohesh mijëra familjeve në këtë vend për të ndryshuar qeverisjen, ndaluar blerjen e votës dhe kthimin e pushtetit në duart e qytetarëve.

***Kryetar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike**

HOROSKOPI

DASHI
Do t'i ndani idetë tuaja me të tjerët dhe do të merrni miratime nga ata që i vlerësoni. Dhe mos u shqetësoni, askush nuk do të ankohej, nëse lëni menjëherë ndonjë hollësi me pak rëndësi. Në horizont shfaqen miqësi për t'i forcur apo për t'i ribuluar, ndoshta pas një kontakti fillestar virtual.

DEMI
I keni besuar një personi që e keni njohur së fundmi dhe tashmë jeni të zhgënjyer nga sjellja e tij, jo shumë korrekte. Planetët nuk janë të favorshëm ndaj jush. Mos e ndërlikoni më tej situatën, mos e prishni ditën dhe pranoni çdo pasojë.

BINJAKET
Falë pozicionit të favorshëm të Neptunit, të tjerët do ju ndihmojnë në punët e shtëpisë, kështu që do arrini të keni pak kohë të lirë për vetel. Jeni gjithmonë të gatshëm të ndihmoni të tjerët dhe asnjëri nuk do refuzojë t'ju japë një ndihmë të vogël, nëse la kërkonin ju.

GAFORJA
Projektet më të rëndësime fillojnë mbarë edhe falë bashkëveprimit të Mërkurit me Neptunit, si dhe mundësisë që keni për t'i shuar talentet që keni. Nuk keni probleme t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja pse do t'ju ndjekin pa u sfurcur.

LUANI
Pozicionimi i Saturnit ju pengon, por ndërkaq ndërhyrja e Neptunit nuk mund të mos ndodhë në një moment më të mirë për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengese. Nëse një gësheje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani me në fund gjithçka zhblokohet.

VIRGJERESHA
Disa angazhime të rëndësime nuk ju lënë kohë që t'i realizoni ashtu si dëshironi. Fatkeqësisht, megjithatë askush nuk duket i gatshëm t'ju ndihmojë. Do t'i kryeni detyrat tuaja edhe të vetëm dhe në mënyrën më të mirë të mundshme.

PESHORJA
Energjia e Jupiterit do t'ju nevojitet së tepërmi në të botën e sipërmarrjes. Do t'ju ndihmojë gjithashtu të kanalizoni më mirë energjitë tuaja, në mënyrë që të ngriteni. Durimi shpërblehet, por në këtë rast nevojitet mbi të gjitha vullneti, që sidoqoftë nuk ju mungon!

AKREPI
Mendohuni dy herë përpara se të krijoni shumë siguri. Disa hapa të ndërmarrja mund t'ju çojnë që të bëni disa zgjedhje të rëndësishme, që do të përfundojnë duke ju ndryshuar jetën.

SHIGJETARI
Për faj të lidhjes midis Marsit dhe Venusit, sigurtë tuaja do të dalin se janë kështjella prej rëre, mbi të cilat nuk mund të keni më besim. Eshhtë më mirë të ecni me ngadalë për të mos u rrezuar, që që nuk mund t'ia lejojnë vetes në këto kohë.

BRICJAPI
Nëse në të kaluarën nuk ia keni dalë të shfrytëzoni të gjithë potencialin e një situatë shumë premtuese. Tashmë, bashkëveprimi i planetëve do t'ua japin mundësinë. Mos rritni duarkryq, sepse tani është momenti që të përsheptoni për të arritur një objektiv të dëshiruar.

UJORI
Sot do të përlotoni një krijimtari të madhe. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë nuk e kuptoni që e tejkaloni masën... Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

PESHQIT
Shfrytëzoni bashkëveprimin e Diellit me Hënë për të shtuar dhuntitë tuaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët tuaja. Nganjëherë nuk duhet të lodheni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

BLUE TOOTH
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta ipave
çdo të shtunë falas me

Katovica

Dashuri ushtarako-fetare Greqi-Serbi

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Shteti dhe diplomacia shqiptare nuk duhet të trullosen nga fiskekzjarrët ballkaniko-perëndimorë të Serbisë dhe as nga sindromat e partneriteteve strategjike të pakthyerë të Greqisë.



... në Marrëveshjen Teknike të krijimit të grupit luftarak rajonal të quajtur "HELBROC", që drejtohet nga Greqia. Akti i pranimit të Serbisë nga Greqia u nënshkrua në kuadër të vizitës që zhvilloi në Athinë ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Aleksandar Vulin, në 27 shtator 2017. "HELBROC" është një nga 15 grupet luftarake të reagimit të shpejtë, që janë krijuar nga vendet e BE si pjesë e Politikës së përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes të BE. Në grupin luftarak rajonal të krijuar dhe të komanduar nga Greqia bëjnë pjesë Ukraina, Qipro, Rumania dhe Bullgaria dhe emri i grupit është akronim i emrave të shteteve pjesëmarrëse. Tani Greqia futi edhe Serbinë, dhe grupi i ashtuquajtur ballkanik u zgjerua në gjashtë shtete, të cilat kontribuojnë me njësi ushtarake dhe me oficerë shtabi. Ndonëse grupet luftarake të reagimit të shpejtë njihen formalisht si pjesë e politikës së mbrojtjes të BE, "HELBROC" është mandat kombëtar i shtetit që e drejton, pra i Greqisë. Fakti që dokumentin e pranimit të Serbisë në "HELBROC" e nënshkroi vetëm Greqia, si shtet komandues i grupit dhe nuk u nënshkrua në Bruksel nga institucione të BE apo përfaqësues të Komisionit Europian, tregon se kemi të bëjmë me një akt shtetëror individual të Greqisë për forcimin e aleancës së saj ushtarake me Serbinë në kuadrin e marrëdhënieve të posaçme, që Athina dhe Beogradi zhvillojnë me njëri-tjetrin. Diplomacia greke e emërton "HELBROC" si "grupim luftarak ballkanik", në një kohë që në të nuk marrin pjesë dy të tretat e shteteve ballkanike, kur në grup janë dy shtete joballkanike dhe kur shtetet ballkanike që nuk marrin pjesë, nuk i kanë autorizuar Athinën ndonjë mandat ballkanik. Grupimi i mësipërm vështirë se mund të thuhet se i përket BE, kur ai ka dy shtete joanëtare të BE, prej të cilëve vetëm njëri është shtet kandidat. Në rajon janë katër shtete të tjera ballkanike candidate të BE, të cilat nuk janë ftuar të jenë pjesë e grupit.

Çfarë tërheq vëmendjen në anëtarësimin e Serbisë në grupimin luftarak të reagimit të shpejtë, të drejtuar nga Greqia.

Së pari, tregon se në të ashtuquajturin Ballkan Perëndimor zgjedhja strategjike dhe ushtarake e Greqisë është Serbia dhe natyra e kësaj aleance ushtarake është e lidhur me bazën e përbashkët fetare. Dy ministrat e mbrojtjes të Greqisë dhe të Serbisë e deklaruan me mburrje karakterin ushtarako-fetar të dashurisë dhe të aleancës greko-serbe. Ministri i Mbrojtjes i Greqisë, Panos Kammenos, në fjalimin që mbajti para ministrit serb të Mbrojtjes, deklaroi dy herë tekstualisht: "Greqia dhe Serbia janë të bashkuar nga besimi ortodoks. Greqia dhe Serbia kanë besimin e tyre të përbashkët ortodoks". Parashtrimi i dimensionit fetar ortodoks si bazë e bashkëpunimit ushtarak midis Greqisë dhe Serbisë është platforma zyrtare mbi bazën e së cilës Greqia dhe Serbia kërkojnë të ndërtojnë aleancën dhe rolin e tyre në gadishullin e Ballkanit. Kjo nuk është e rastit, sepse si Greqia, ashtu dhe Serbia, në doktrinat e tyre të sigurisë kombëtare e kanë kriterin fetar një nga shtyllat kryesore dhe doktrinat e tyre të sigurisë kombëtare kanë në shënjestër popuj dhe shtete, që nuk janë ortodoksë. Doktrina e sigurisë kombëtare e Greqia konsideron burim rreziku Turqinë dhe doktrina e sigurisë kombëtare e Serbisë konsideron të tillë kombin shqiptar në të dy shtetet shqiptare dhe kombin kroat.

Ideologjinë fetare Athina e ka konceptuar si saldim të strukturimit të grupit luftarak "HELBROC", në të cilin jo rastësisht janë grumbulluar prej saj vetëm shtete ortodokse si Greqia, Ukraina, Rumania, Bullgaria, Qipro dhe Serbia.

Nuk mund të mos shtrohet pyetja se si Greqia, një shtet anëtar i NATO-s, nuk ka ftuar në një grup luftarak të drejtuar prej saj në kuadër të politikës europiane të sigurisë dhe të mbrojtjes as Shqipërinë dhe as Malin e Zi, që janë shtete anëtare të NATO-s dhe të cilat janë të detyruara nga Neni 5 i Traktatit themelues të NATO-s që të mbrojnë Greqinë, në rast se ajo do të jetë objekt agresionit nga një palë e tretë. Ftohen të bëhen anëtarë Ukraina, Qipro dhe Serbia, që nuk janë anëtarë të NATO-s, (Serbia madje ka qëndrim zyrtar armiqësor ndaj NATO-s), dhe nuk ftohen Shqipëria, një shtet fqinj, i cili me një vokacion inferioriteti strategjik ka 16 vjet që në programet qeveritare të politikës së jashtme e shpall vazhdimisht Greqinë aleat strategjik. Është një dëshirë e njëanshme, sepse për shembull kryeministri grek Cipras gjatë tre vjetëve në atë post

nuk ka deklaruar kurrë se qeveria e tij e konsideron Shqipërinë aleat strategjik, kurse për Serbinë e deklaroi publikisht sa herë takon udhëheqësit serbë, siç bëri edhe në qershor të këtij viti në takimin e Selanikut.

Së dyti, nga këndvështrimi shqiptar bie në sy jo për të mirë se në grupin luftarak "HELBROC" Greqia ka përfshirë pesë shtete, që nuk e njohin Kosovën dhe vetëm një shtet, Bullgaria, e njeh. Ky element nuk mund

të mos çojë tek opinioni i ekzistencës së një prirjeje antishqiptare të grupimit, sepse duke u drejtuar kundër Kosovës, drejtohet kundër interesit të kombit shqiptar. Ky element i qëllimshëm është kaq i dukshëm, sa që

Marrëdhëniet ndërkombëtare në Ballkan janë ndërtesa me shumë kate dhe jo në të gjitha katet bëhen festivale rinie

ministri i Mbrojtjes i Serbisë e lavdëroi publikisht në fjalimin e tij në Athinë këtë kompozim anti-Kosovë të grupit "HELBROC": "Sipas përbërjes së grupit, siç e shihni, ne jemi midis miqsh. Nuk është e rastit që vetëm një shtet nga grupi e ka njohur Kosovën, kurse të tjerët jo. Ne jemi shumë të kujdesshëm për këtë kur zgjedhim ku të jemi dhe në cilin grup të bëjmë pjesë". Emocioni antishqiptar ndikoi me sa duket që ministri i Mbrojtjes i Greqisë u drejtua delegacionit të ministrisë së Mbrojtjes të Serbisë me thirr-

rjen emfatike: "Vëllezër serbë, grekët janë me ju". As në mediat dhe rrjetet sociale greke dhe as në mediat dhe rrjetet sociale serbe nuk pat protesta pse ministri grek i Mbrojtjes i quajti serbët "vëllezër".

Së treti, aleanca ushtarako-fetare Greqi-Serbi me përfshirjen e Serbisë në grupin luftarak të Athinës, shfaq hapur një prirje të qartë anti-NATO. Ministri i mbrojtjes i Serbisë mburri ministrin e Mbrojtjes të Greqisë, Kammenos, se ai i ka kundërshtuar në vitin 1999 bombardimet e NATO-s mbi Serbi, është solidarizuar me qeverinë serbe të asaj kohe dhe në shenjë solidariteti paska bërë edhe një vizitë në Beograd në kohën e bombardimeve. Dhe Kammenos, që për ironi të politikës greke është ministër i Mbrojtjes i një shteti të NATO-s, në mënyrë skandaloze vazhdon të mbajë po atë qëndrim armiqësor ndaj NATO-s edhe sot në vitin 2017. Në 27 shtator ai e quajti Serbinë e Millosheviçit viktimë dhe mori hapur në mbrojtje kriminelin ndërkombëtar të luftës Slobodan Millosheviç, duke e quajtur të pafajshëm.

Së katërti, Greqia dhe Serbia po dalin tani hapur me idenë dhe pretendimin e rrezikshëm që aleanca e tyre ushtarako-fetare të marrë rolin e një gardiani rajonal mbi popuj dhe shtetet e tjera të rajonit. Ministri i Mbrojtjes i Greqisë e shprehu hapur këtë pretendim për rol kontrollues greko-serb në Ballkan, kur deklaroi se Greqia dhe Serbia "mund të ndërtojnë së bashku një aks stabiliteti, që do të interceptojë përpjekjet e disa njerëzve të importuar fanatizmin fetar veçanërisht në Ballkan".

Përballë frymës joatlantike dhe joeuropiane të kësaj aleance ushtarako-fetare të Greqisë dhe të Serbisë është e drejtë të pritet që BE dhe NATO të kërkojnë shpjegime nga Athina lidhur me pasojat që mund të sjellin në Ballkan aleancat dhe politikën me flamuj fetarë të dy shteteve të mësipërme. Në BE dhe në NATO e njohin mirë strategjinë afatgjatë të Rusisë për të krijuar në Ballkan një aleancë të shteteve ortodokse, të lidhura me Moskën. Në këtë strategji ruse, Greqia dhe Serbia po marrin role kryesore në rajon. Jo rastësisht Greqia, Serbia dhe Qipro, (gjysma e HELBROC-ut) kanë qeveritë më proruse të kontinentit, janë shtete të cilat kanë refuzuar sanksionet e BE ndaj Rusisë, nuk kanë dënuar kurrë agresionin e Rusisë kundër Ukrainës dhe as aneksimin e dhunshëm të Krimesë nga Rusia. Janë shtete që kanë pranuar orientimin e marrëdhënieve të tyre me Rusinë të bazuar në aksin fetar ortodoks.

Këto zhvillime duhet të ndiqen me kujdes të veçantë nga shteti dhe diplomacia shqiptare. Marrëdhëniet ndërkombëtare në Ballkan janë ndërtesa me shumë kate dhe jo në të gjitha katet bëhen festivale rinie. Greqia dhe Serbia e shohin kombin shqiptar dhe faktorin shqiptar në Ballkan si pengesë të planeve të tyre për hegjemoni në rajon. Një aleancë ushtarako-fetare Greqi-Serbi ka në themelet e saj urrejtjen nacionale dhe fetare ndaj kombit shqiptar, nëse në flamurin e saj qëndron armiqësia ndaj shtetit të Kosovës. Kjo do të thotë që zyrat shtetërore të Shqipërisë duhet të ndalen shumë për të analizuar sfondin antishqiptar të zhvillimeve të përditshme në rajon. Kjo do të thotë që Shqipëria duhet të mos e humbë sensin realist në raportet me të dy shtetet ballkanike, me të cilat historia na ka lauruar me një shkollë të madhe. Shteti dhe diplomacia shqiptare nuk duhet të trullosen nga fiskekzjarrët ballkaniko-perëndimorë të Serbisë dhe as nga sindromat e partneriteteve strategjike të pakthyerë të Greqisë.

Bavarezët barazojnë 2-2 ndaj Hertës së Berlinit

Me apo pa Ançelotin, Bajerni sërish zhgënjën

Bajerni i Mynihut nuk bdel nga kriza e rezultateve pavarësisht shkarkimit nga detyra të trajnerit italian Karlo Ançeloti. Bavarezët nuk shkuan më tej se një barazim 2-2 në ndeshjen e sotme të Bundesligës në transfertë



ndaj Hertës së Berlinit. Hums kaloi Bajernin në avantazh në minutën e 10-të, ndërsa Levandovski shënoi golin e dytë në minutën e 49-të. Megjithatë vendasit u kthyen shpejt në lojë, teksa Duda shënoi në minutën e 51-të, ndërsa Kalu në minutën e 56-të. Pas këtij takimi, Bajerni numëron 14 pikë në 7 ndeshje, duke qëndruar në vendin e dytë, me 5 pikë diferencë nga kryesuesit e Dortmundit. Tifozët e bavarezëve kanë shprehur mbështetje e tyre për ish-trajnerin Ançeloti me një

banderolë të madhe të shpalosur në stadium. Ata kanë dalë hapur kundër vendimit të klubit për shkarkimin e italianit. Ndërkohë, mesfushori Frank Riberi ka pësuar një dëmtim të rëndë dhe ka lënë fushën në minutën e 62-të.

Lacio e Strakoshës luan tenis me Sasuolon. Krotone dhe Ajeti barazojnë ndaj SPAL-it

Interi thyen Gjimshitin dhe Memushajn

Hysaj dhe Napoli fitojnë të shtatën radhazi



Jeton Selimi

Mbrojtësi i Kombëtares shqiptare, Berat Gjimshiti, ka debutuar me skuadrën e Benetos në Serinë A. Ekipi i tij dhe i Memushajt u mposht në shtëpi nga Interi me rezultatin 1-2. Brozović shënoi dy gola në minutat 19 dhe 22, ndërkohë që D'Alesandro ngushtoi diferencën për vendasit në minutën e 42-të. Gjimshiti qëndroi në fushë për 90 minuta të plota, ndërsa shoku i tij i skuadrës, Ledian Memushaj, e nisi ndeshjen si titullar, por u zëvendësua në minutën e 66-të. Napoli i Elseid Hysajit fitoi lehtësisht 3-0 në shtëpi ndaj Kaljarit. Hamshik shënoi golin e parë në minutën e 4-rt. Një gol i veçantë ky për këtë lojtar, pasi ishte i 114-ti me fanellën napolitane, duke kaluar kështu dhe një nga lojtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave që kanë luajtur me këtë ekip, Diego Armando Maradonën. Ndërkohë që Mertens realizoi me penallti në minutën e 40-të. Goli i tretë u shënua nga Kulibali në minutën e 47-të. Hysaj qëndroi në fushë për 90 minuta të plota.

Lacio vazhdon të tregojë një formë fantastike teksa shkatërroi në shtëpi me rezultatin 6-1 Sasuolon. Berardi kaloi miqtë në avantazh në



minutën e 27-të me penallti, por Alberto barazoi shifrat në minutën e parë shtesë të pjesës së parë. Në pjesën e dytë të kaltrit gjetën me lehtësi 5 herë portën kundërshtarë falë De Vrij në minutën e 56-të, Alberto në të 57-ën, Parolo në të 64-ën dhe 69-ën dhe Imobile në të 81-ën me

penallti. Strakosha si zakonisht ishte në portën e Lacios gjatë të gjithë lojës. Krotone e Arlind Ajetit barazoi në transfertë me rezultatin 1-1 përballë Spalit. Ajeti ishte në fushë për 90 minuta të plota. Mbrojtësi i Kombëtares u vlerësua me notën 6,5 nga Tuttomeratoweb.com: "Ësh-

të gjithmonë tepër inteligjent dhe për të bërë mbrojtësin kjo është një karakteristikë e rëndësishme. E di gjithmonë kur duhet të marrë pozicion. Evitoi një autogol".

Në ndeshjet e tjera, Kievu mposhti Fiorentinën 2-1, ndërsa Torino barazoi 2-2 me Veronën.

MILANI

Milani nuk "ngre kokë" në Seria A as në kryendeshjen e javës së 7-të ndaj Romës. Kuqezinjët janë mundur në "San Siro" 0-2, duke pësuar disfatën e dytë radhazi në kampionat, dhe duke vendosur seriozisht të ardhmen e Montellës. Pjesa e parë dhuroi pak emozione, teksa të dyja skuadrat nuk patën mundësi shënimi. Në fraksionin e dytë Milani e nisi më mirë ndeshjen, duke gënjë shumë pranë golit me Bonuçin dhe Kalinic. Kur nuk shënon, do e pësosh, dhe kështu me sa duket ndodh edhe me kuqezinjët. Dzeko në minutën e 75-të vendos hesh-tjen në "San Siro", ndërkohë që Florenzi vulos suksesin që e ngjiti Romën në vendin e 5-të me 15 pikë. Për t'u shënuar është edhe fakti që Calhanoglu u ndëshkua me kartonin e dytë të verdhë 10 minuta nga fundi. Milani mbetet në vendin e 7-të, me 12 pikë.

FORMULA 1



Fiton Verstapen, por çfarë gare Fetel!

Hollandezi Maks Verstapen është triumfuesi në garën e Sepangut për Çmimin e Madh të Malajzisë. Kjo fitore ishte e dyta për 20-vjeçarin në karrierën e tij, vetëm dy javë pas incidentit në startin e Singaporit, që nxori jashtë gare Sebastian Fetelin dhe Kimi Raikonen. Piloti i Red Bull parakaloi që në xhirot e para Hamiltonin dhe nuk e lëshoi kreun pothuajse për asnjë moment. Në vendin e dytë u rendit pikërisht numri një i Mercedesit, Luis Hamilton, ndërsa në podium u ngjiti një tjetër pilot i Red Bull, Daniel Riccardo, i cili u pozicionua në vendin e tretë. Piloti i Ferrarit, Sebastian Fetel, pavarësisht se u nis nga vendi i fundit pas problemeve në provat gjenerale e mbylli garën në vendin e 4-rt. Ndërsa Kimi Raikonen u tërhoq që në fillim për shkak të një problemi teknik. Renditja për pilot kryesohet nga Luis Hamilton me 263 pikë. Fetel e ndjek në vendin e dytë me 235 pikë, ndërsa në vendin e tretë pozicionohet Botas me 212 pikë. Renditjen për konstruktorë e kryeson Mercedes me 475 pikë, i ndjekur nga Ferrari me 373 pikë dhe Red Bull me 230 pikë.

LA LIGA

Barcelona fiton në një stadium të boshatisur

Vështirë se mund të gjejmë një ndeshje kaq të shkretët në historinë e stadiumit "Camp Nou". Barcelona ka fituar 3-0 në ndeshjen e javës së 7-të ndaj Las Palmas, teksa në stadium nuk kishte asnjë të pranishëm. Një atmosferë që u ngjasonte sfidave të kampionatit shqiptar në vitet e kaluara, teksa këtë herë ishte një masë e marrë për shkak të referendumit të Katalonjës. Fillimisht ndeshja ishte menduar që edhe të shtyhej, por fakti që do të humbeshin 6 pikë për shkak të rregullores, solli edhe këtë vendim. Në fushën e lojës ai që shkëlqen është i përhershmi, Lionel Messi, i cili shënon një dopietë personale duke arritur në shifrën e 45 golave në vitin kalendarak 2017. Ndeshje krenarie edhe për Busquets, i cili gjeti rrugën e rrjetës që mungonte prej 1036 ditësh, që nga nëntori i 2014-ës.



DREJTORI I LACIOS

Tare ngacmon italianët: E sigurt, fiton Shqipëria

Sfida e fundit e kualifikueseve për Botërorin "Rusi 2018" do të jetë një ëndërr për shumikënd nga sportdashësit shqiptarë. Hera e parë që skuadra kombëtare e Italisë do të vijë në vendin tonë. E kush më mirë se një ish-bomber kuqezi i Kombëtares që ka bërë karrierë të lavdishme si futbollist dhe aktualisht si drejtues mund të flasë për këtë përballje! "Shqipëri-Itali? Sigurisht që fiton Shqipëria. Nuk kam asnjë dyshim", ka deklaruar Tare mes buzëqeshjesh në mikrofonin e "Premium Sport".



PREMIER LIGA

Liverpuli merr vetëm një barazim në Njukastëll

Liverpuli nuk shkoi më shumë se barazimi 1-1 në transfertën me Njukasëll Junaitid. Filip Kutinjo shënoi një gol të jashtëzakonshëm për Liverpulin me një guajtje nga distanca në minutën e 29-të, i 17-ti i tij nga jashtë zonës gysë nga debutimi i tij në Premier Ligë, më shumë se çdo lojtar tjetër. Barazimi për Njukasëllin u arrit shtatë minuta më pas, kur pas një korridorit të thellë, Joselu fitoi duelin me mbrojtjen liverpulase duke mposhtur portierin Mingolet. Pas shtatë ndeshjes, Liverpuli i trajnerit Jurgen Klopp ndodhet në vendin e 7-të, me 12 pikë.



Sulmuesi nuk shfajëson veten, por u kundërpërgjigjet akuzave të teknikut Shpëtim Duro

Plas në Vlorë, Alvesh: S'ka 'feeling' mes meje dhe Duros

Braziliani reagon pas kritikave të trajnerit

Jeton Selimi

Sulmuesi brazilian i Flamurtarit, Danilo Alvesh, ka shpërthyer ndaj trajnerit Shpëtim Duro me anë të një postimi në faqen e tij në "Facebook". Ai nuk është i kënaqur nga kritikave të shpeshta publike që numri një i panikës lëshon në drejtim të tij, ndaj kërkon që të ulet në stol në rast se është problemi që skuadra nuk fiton. Shpëtim Duro ka sulmuar lojtarin brazilian për të dytën herë në këtë kampionat, ndërsa në jo pak raste është shprehur kritik ndaj tij, çka ka bërë që mes sulmuesit brazilian dhe trajnerit kryeqytetas të krijohet një hendek që duket se nuk do kalojë lehtë. "Ne mund ta kishim fituar lojën dje (të shtunën), por për fat të keq patëm një barazim në shtëpi. Edhe një herë tjetër që trajneri më fajëson mua. Mendoj se ai duhet të pranojë gabimet e tij si trajner, disa lojtarë luajnë jashtë pozicionit. Skuadra nuk mund të shkëmbejë pozicionet midis mbrojtjes dhe mesfushës për të hedhur topin në sulm. Mund të them që kisha mjaft gabime dje, por isha i vetmi lojtar që më të shumtën e kohës e vendosi topin në tokë për ta mbajtur atë, ndryshoi kalimet dhe provoi diçka në fushë. Trajneri nuk më ka qejf mua, ashtu siç nuk e kam unë atë. Ne duhet të bëjmë më të mirën për Flamurtarin, kështu është e thjeshtë, le të vendosë një lojtar tjetër në lojë."

Nuk është faji im për çdo gjë që shkon keq. Skuadra ka 11 lojtarë dhe secili lojtar duhet të marrë përgjegjësitë e tij, veçanërisht trajneri. Jam lodhur që gjithmonë është e njëjta gjë "Danilo Alves është problemi", "Nuk jam i lumtur me Danilo Alves". Nëse nuk është i lumtur, atëherë le të vendosë një lojtar tjetër. Unë heq dorë dhe trajneri mund të qëndrojë me skuadrën e tij. Dua të lë përgjigjen time këtu, sepse për çdo rezultat negativ, trajneri flet keq për mua nëpër gazetë."

ÇFARË THA DURO

Pas barazimit me Luftëtarin, ka folur për mediat edhe trajneri i Flamurtarit, Shpëtim Duro. Trajneri tha për "Supersport" se skuadra kishte shumë raste për të shënuar, por lojtarët nuk u treguan të qartë para portës dhe Alvesh humbi shumë topa dhe bëri një paraqitje të tmerrshme. "Sigurisht që e kam tënë që çdo ndeshje ka rëndësinë e saj, skuadrat duhen respektuar të gjitha, pasi skuadrat janë të gjitha shumë të përgatitura. Nuk ishim agresivë sa duhej në minutat e para. Presioni nga tifozëria ndikoi në lojën e skuadrës. Pjesën e dytë patëm epërsi, por nuk patëm

| SUPERLIGA | |
|----------------------|-------|
| JAVA E 4-t | |
| TË SHTUNËN | |
| Flamurtari-Luftëtari | 0-0 |
| Laçi - Villaznia | 2-0 |
| TË DIELËN | |
| Kamza-Teuta | 1-1 |
| TË HËNËN | |
| Kukësi-Skënderbeu | 14:00 |
| Partizani-Lushnja | 17:00 |

fat dhe nuk ishim të qetë para portës. Nëse do të kishim shënuar, rezultati do ishte ndryshe. Kemi mbuluar mjaft mirë dy pikat më të forta të kundërshtarit, Bregun dhe Abazajn, por duhej të kishim bërë më shumë. Në pjesën e dytë, me aktivizimin e Zhupës pati ndryshime, Alvesh pati shumë topa, por humbi jashtëzakonisht shumë topa, 7-8 raste,



dhe nuk mund ta kërkon të shumë topin. Kundërshtari nuk na sulmoi fare. Ishte plotësuar numri i katër të huajve, prandaj Zhupa

nuk mund të aktivizohej. Për sa i përket kujdesit që treguam me shumicë, duhet të jesh i kujdesshëm për lojtarë si Bregu dhe Abazaj.

Mbrojtja ishte jashtëzakonisht shumë mirë, por ishte sulmi ai që çaloi. Danilo ishte skandal me topat e humbur."

TRAJNERI I KAMZËS

Ndreu: Kërkoj ndjesë për kartonin e kuq



Trajneri Ramadan Ndreu u largua nga pankina me karton të kuq, 5 minuta nga fundi i lojës për protestë të ashpra ndaj gjyqtarit Xhaja, ku teknikun i Kamzës pretendoi për një 11-metërs në favor të skuadrës së tij. Pas konsultimit me pamjet filmike, në një prononcim për "Supersport", Ndreu e ka pranuar se është nxjatur dhe gjyqtari ka vepruar drejt. Trajneri tregon se, në qoftë se skuadra do ishte treguar më e kujdesshme në rastet e krijuar në pjesën e dytë, mund ta kishte fituar takimin. "Jam i mërziutur, sepse lojtarët nuk arritën të interpretonin kapacitetin që kanë. Po të ishim më të kujdesshëm, mund ta kishim fituar ndeshjen. Për rastin e Fushtar menduam se ishte penallti. Tani po e shoh që nuk ishte penallti, por nga stoli u duk si penallti e pastër. Tërhiqem! Futja e 4 lojtarëve të huaj në formacion, na kushtëzoi në zëvendësimet. Ndërrimin e Lelis e bëra për të forcur mesfushën. Në pjesën e dytë loja ndryshoi me futjen e Arrabal në fushë. Mungesa e tifozëve? Është një gjë që po e vras mendjen dhe nuk po e kuptoj, pse nuk vijmë tifozët. Është e çuditshme! Ekipi është në rrugën e duhur, ka grup të mirë, e ka mobilizimin dhe nuk e humb kurrë. Duhet të bëjmë më mirë në fazën e sulmit."

TRAJNERI I TEUTËS

Magani: Ishim më superiorë, meritonim fitoren



Trajnerin Magani nuk e kënaq barazimi i djeshëm në transfertë ndaj Kamzës. Në prononcimin për "Supersport" pas ndeshjes, teknikun ka deklaruar se skuadra ka humbur 2 pikë në këtë sfidë dhe në qoftë se do ishte treguar më e kujdesshme do e kishte fituar takimin. "Për mua kemi lënë 2 pikë. Pas golit, u tërhoqëm vetë, jo për meritë të kundërshtarit. Duhej të ishim treguar më profesionist dhe ta kishim dyfishuar rezultatin. Skuadra nuk është akoma gati për nivele të larta. Nuk kishim as ndërrime të cilët mund t'i përgjigjeshin ekipit. Në fillim kemi qenë superiorë ndaj kundërshtarit, më pas kemi lëshuar në lojë. Për sa i përket gabimit, është një gabim që ndodh kudo. Ishte një ngritje dore instiktive. Po të kishte vazhduar loja edhe 5 minuta, mund të ishim mundur. Dediç? E ka kryer mirë menaxhimin e topave, edhe pse ishte një pozicion i ri për të. E zëvendësova sepse shpenzoj shumë energji. Në raport me ndeshjet e tjera, jam i kënaqur me Dediçin. Ne ishim më superiorë se Kamza. Unë nuk bëj modestin, kemi mbjellë një farë të mirë që do shërbim. Kam vërejtje për disa lojtarë. Të gjithë duhet të sakrifikojnë për skuadrën. Ka lojtarë që nuk e justifikojnë fanellën."

NDESHJA E SË DIELËS

Kamza prish dhe ndreq vetë për një pikë ndaj Teutës

Kamza nuk e gjen fitoren e parë në këtë kategori superiore as pas javës së katër, ndërsa në përballjen me Teutën, kamzalinjtë nuk shkuan më larg sesa një barazim 1-1, ndonëse zhvilluan një 90-minutësh më të mirë sesa bregdetarët, që nga ana e tyre ende nuk po gjejnë ritmin e dy javëve të para të kampionatit. Në minutën e dytë vjen mundësia e parë për Teutën, me Latif që bën gjithçka mirë përveçse pasimin e fundit, duke gabuar në shërbimin për Dediç. Në të 28-ën Hrakac harkon një top në zonë, topi kalon gjithë pasqyrën e portës, pa arritur të devijohet në rrjetë nga Dediç. Shfaqet Kamza në të 32-ën me Frashërin që krosron drejt shtyllës së dytë për Fukuin, mesfushori nuk arrin të koordinohet siç duhet me kokë, duke e dërguar topin jashtë kuadrantit. 13 minuta më pas Kamza ka një rast të mirë sërish me japonezin, që nuk gjen kuadrantin pas harkimit të Nezirit. Pjesa e parë mbyllet me rrjeta të paprekura, ndërsa në të dytën miqtë shënojnë shumë shpejt. Lena jep një asist për Latif në të 53-ën. Ganezi nis një pasim për në qendër, por devijon aty Frashëri, i cili shkarkon autogol. Kamza nuk pajtohet me rezultatin dhe nis ofensivën në kërkim të barazimit. Në minutën e 55-të Imeri provon me një guajtje nga distanca, topi grushtohet nga Shkalla në goditje këndi. Në të 77-ën Mehmeti sheh t'i mbetet topi në këmbë dhe gjuan nga distanca e afërt, por reagon shumë mirë Kast-rati, që eviton një gol të sigurt. As 60 sekonda dhe Kamza i afrohet sërish golit, kësaj radhe me Ermir Rezin që fare pranë vijës fatale shpërdoron në mënyrë të pabesueshme. Presioni i Kamzës rritet dhe në të 86-ën porta e Teutës shpëton për mrekulli pas guajtjes me kokë të Raçiç, me topin që del ngjitur me shtyllën. Por për t'i dhënë një dorë Kamzës mendon vetë Teuta dhe është Hrakac që në mënyrë të pabesueshme prek topin me dorë në zonë, duke detyruar Xhaxhën të vërshtëllëjë 11-metërsin, të cilin e kthen në gol serbi Raçiç. Kamza përpiqet deri në fund të fitojë takimin, por gjithçka do mbyllet me shifrat e barabarta 1-1. Teuta ngjitet në kuotën e 7 pikëve dhe kap ekipet e kreut, ndërsa Kamza ka 3 pikë pas 4 javëve të para.

Këshilla

Jeni në ankth, të shqetësuar, të frikësuar? Rrahjet e zemrës suaj janë të shpejta, frymëmarrja dhe mendimet janë të shpejta dhe e vetmja gjë që doni është të relaksoheni? Ka shumë medikamente, që nuk përfshijnë drogat, kundër ankthit, duke filluar nga teknikat e meditimit deri te çajrat qetësues.



1. KAMOMILI

Nëse po përjetoni një çast nervozizmi, një filxhan çaj kamomili mund t'ju ndihmojë të qetësoheni. Disa përbërës që gjenden te kamomili (*matricaria recutita*) veprojnë te receptorët e trurit në të njëjtën mënyrë si valiumi. Ju mund ta merrni atë edhe si suplement të standardizuar, i cili përmban 1.2% apigenin (një përbërës aktiv), së bashku me lule të thata kamomili. Sipas një studimi të Universitetit të Pensilvanisë, pacientët me çrregullime ankthi, të cilët kanë marrë suplemente kamomili për 8 javë, kanë pasur një rënie të konsiderueshme të simptomave të ankthit krahasuar me pacientët që merrnin hape qetësuesish.

2. L-THEANINË (OSE ÇAJ JESHIL)

Aminoacidi i quajtur L-theaninë i gjendur në çajin jeshil, ndihmon në frenimin e rrahjeve të shpeshta të zemrës dhe presionit të lartë të gjakut. Disa studime kanë zbuluar se ky aminoacid gjithashtu lufton ankthin. Në një studim për ankthin, rezultoi se personat, të cilët kishin marrë 200 mg L-theaninë para një provimi, ishin më të qetë dhe më të fokusuar. Ju mund ta merrni L-theaninën nga çaji jeshil, por duhet të pini 5-20 filxhanë në ditë.

3. BAR BLETE

Kjo bimë është përdorur që në kohën e Mesjetës për të reduktuar stresin, ankthin dhe për të stimuluar gjumin. Në një studim të

kryer me vullnetarë të shëndetshëm, është zbuluar se ata që merrnin në mënyrë standarde (600 mg) ekstrakt bar blete, ishin më të qetë dhe më të vëmendshëm se ata që merrnin qetësues nervorë. Por duhet të jeni të kujdesshëm, sepse disa stu-

dime kanë treguar që dozat e larta të këtij qetësuesi mund të rrisin më tej ankthin. Fillojeni me doza të vogla. Bari i bletës shitet si një çaj, kapsulë, ose tretësirë. Shpesh, bari i bletës kombinohet me bimë të tjera qetësuese si kamomili dhe sanëza.

4. USHTRIMET

Ushtrimet janë të dobishme për trurin dhe një antidot i fuqishëm për ankthin dhe stresin. Nëse ju stërviteni mbi baza të rregullta, do të kenë më shumë vetëbesim dhe do të ndiheni të shëndetshëm. Një nga shkaqet

më të njohura të ankthit, është frika rreth sëmundjeve dhe shëndetit, ndërkohë që kur jeni të aftë fizikisht dhe të shëndetshëm, ankthi zhduket.

5. MERRNI OMEGAS

Ju e dini që vajit i peshkut është i mirë për zemrën dhe

mbron edhe kundër depressionit. Shtoni dhe ankthin në listë. Sipas një studimi, studentët që merrnin 2.5 mg acide yndyrore omega-3 të miksuara, për 12 javë, kishin më pak ankth para provimit se ata që merrnin ilaçe nervore. Ekspertët në përgjithësi rekomandojnë që ta merrni omega-3 nga ushqimet kur është e mundur. Salmoni, sardelet, midhjet përmbajnë acide yndyrore omega-3.

6. NGRROHTËSIA ÇLIRON ANKTHIN

Një dhomë me avull do të ishte si një magji për çlirimin e ankthit. Ngrrohta e trupit redukton tensionin e muskujve dhe ankthin. Ndjesia e të ngrrohtit mund të ndikojë te neurotransmetuesit si serotonina. E ngrrohta është gjithmonë një mënyrë e mirë, për të mos përmendur të qenit para një oxhaku me zjarr me një filxhan çaji në dorë.


7. BËNI NJË SHËTITJE NË PYLL

Hulumtuesit japonezë kanë matur ndryshimet e trupit te njerëzit që ecin për 20 minuta në pyll, nën aromën e drurëve dhe rrjedhës së lumit. Pas kësaj shëtitjeje, nivelet e hormoneve të stresit ishin më të ulëta.

7 qetësues natyralë kundër ankthit



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishtë dekreti i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.
38. Satelit i Jupiterit.

39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstre me sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Eshhtë gjuajta personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendl.
7. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.

12. Ishtë gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihat kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsa e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë sklavëri.
16. Eshhtë shtypi jo përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Spërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL

33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.


VERTIKAL

9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëllhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.




9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëllhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 9 | | 8 | | 5 | | | |
| 3 | | | 5 | 1 | 9 | | | 6 |
| 6 | 2 | | 4 | | | 8 | 9 | |
| | | 1 | | | 8 | 9 | | |
| 7 | 4 | | | | | 3 | 1 | |
| | 5 | | 3 | | | 2 | | |
| 5 | 6 | | | 2 | 7 | 4 | | |
| 4 | | | 9 | 7 | 3 | | 8 | |
| | | 3 | | 4 | | 1 | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 8 | 7 | 3 | 6 | 1 | 9 | 2 | 5 |
| 6 | 3 | 2 | 7 | 5 | 9 | 4 | 8 | 1 |
| 5 | 1 | 9 | 2 | 4 | 8 | 3 | 6 | 7 |
| 9 | 4 | 6 | 1 | 8 | 3 | 5 | 7 | 2 |
| 2 | 7 | 1 | 5 | 9 | 6 | 8 | 3 | 4 |
| 8 | 5 | 3 | 4 | 2 | 7 | 6 | 1 | 9 |
| 7 | 6 | 4 | 8 | 1 | 5 | 2 | 9 | 3 |
| 3 | 9 | 5 | 6 | 7 | 2 | 1 | 4 | 8 |
| 1 | 2 | 8 | 9 | 3 | 4 | 7 | 5 | 6 |

Argëtim filozofik

- Eshhtë e preferueshme të mos bëhet një vepër e bërë keq, sepse më pas do pendohemi. Atë që bëjmë, më mirë ta bëjmë të rregullt (mirë), për të mos u penduar më pas.
- Urrejta nuk ndalet nga urrejta, në asnjë kohë; urrejta pushon nga dashuria: ky është ligji i përgjeshëm.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|-----|
| 8 | 4 | 1 | 2 | 3 | 4 | 6 | 5 | 3 | 4 | 1 | 4 |
| 1 | 2 | 8 | 1 | 5 | 8 | 4 | 7 | 10 | 6 | 4 | 3 |
| 10 | 6 | 7 | | 2 | 7 | | 11 | 6 | 2 | 1 | 4 |
| 10 | 7 | | 15 | 1 | 12 | 1 | 2 | 3 | 4 | | 10 |
| 1 | | 12 | 1 | 4 | 3 | 2 | 6 | 4 | 3 | | 1 |
| 4 | 2 | 6 | 11 | 3 | 2 | 6 | 4 | 3 | | 1 | 14 |
| 1 | 2 | 4 | 16 | 2 | 7 | 16 | 6 | | 18 | 1 | 4 |
| | 1 | 2 | 8 | 3 | 14 | | 3 | 1 | 1 | | 1 |
| 1 | 19 | 1 | | 4 | | 11 | 3 | 4 | 2 | 6 | 15C |
| 8 | 1 | 5 | 4 | | 18 | 6 | 2 | 1 | 4 | 3 | 2 |
| | 5 | 16 | 1 | 10 | 6 | 4 | 3 | 4 | 6 | | 3 |
| 10 | 3 | | 15 | 3 | 18 | 6 | | 14 | 5 | 14 | 1A |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| K | O | D | I | A | D | P | A | L |
| A | R | E | S | T | I | S | M | L |
| N | A | D | H | E | R | E | T | I |
| I | R | M | O | N | I | T | O | R |
| B | K | A | P | I | T | A | L | I |
| A | L | A | P | S | A | T | A | A |
| L | E | A | E | T | L | M | T | I |
| I | S | R | E | I | N | E | T | I |
| P | I | S | S | O | D | A | M | O |
| S | E | K | R | E | T | L | G | O |
| A | L | E | L | O | N | D | R | A |
| T | E | T | A | B | D | E | R | A |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | O | K | A | T | L | U | F | R | A | N | Z |
| A | R | E | S | F | I | M | A | Z | | | |
| L | I | N | V | E | N | T | I | L | A | T | O |
| L | E | P | E | R | D | I | T | S | H | M | E |
| J | T | E | R | K | O | R | I | S | T | E | T |
| A | S | A | M | A | R | A | | | | | |
| H | E | L | O | R | E | N | M | A | R | E | A |
| H | A | M | E | S | I | S | U | R | R | A | T |
| U | R | I | T | H | S | U | R | R | A | T | |
| T | I | R | O | I | D | E | T | I | T | V | O |
| I | E | N | I | T | A | K | A | S | A | R | |
| M | M | E | N | T | E | S | H | T | A | T | E |

FJALËKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | A | H | L | E | R | K | R | N | O | T | A |
| I | N | E | S | A | M | K | O | D | T | E | N |
| S | T | R | S | E | N | D | E | R | E | T | |
| T | E | A | P | E | N | D | I | M | I | A | I |
| E | N | M | E | N | D | I | M | I | S | G | |
| R | A | A | G | E | T | E | V | E | L | O | |
| I | T | R | I | Z | A | N | A | K | I | N | |
| O | A | K | A | T | S | A | R | N | A | | |
| Z | A | B | E | L | M | I | M | E | D | | |
| E | M | E | G | A | L | T | O | R | | | |
| T | O | K | A | L | A | L | D | E | R | A | |
| P | A | L | A | D | I | N | E | S | T | O | P |

FJALËKRYQI (2)

Ehënie të mënçura

- **BUDA**
- Udhëtar, nëse nuk takon një shoqëruer më të mirë ose të ngjashëm me veten, vazhdon i bindur vetëm: nuk bëhet shoqëri me budallain.
- Ashtu si një shkëmb masiv nuk tundet nga era, ashtu edhe të mënçurit nuk lëkunden mes fajtimeve dhe lavdërimeve.

- **Mjeshtëri magjik, Da Vinçi**
- Të gjithë ankohemi për kujtesë të pamjaftueshme, por asnjë deri më sot nuk është ankuar për mungesë arsyetimit të shëndoshë. **(Laforushko)**
- Ata që nuk kërkojnë asgjë edhe vetë nuk japin asgjë. **(Gille)**

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

